

INTERVISTË ME MEVLYDE MEZININ SARAÇIN

Prishtinë | Data: 28 prill, 2021

Kohëzgjatja: 196 minuta

Të pranishëm:

1. Mevlyde Mezini Saraçi (E intervistuar)
2. Anita Susuri (Intervistuesja)
3. Besarta Breznica (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Anita Susuri: Zonja Mevlyde, nëse mundeni me u prezantu, vitin e lindjes edhe diçka për familjen e juaj? Prejardhjen?

Mevlyde Mezini Saraçi: Po, unë jom Mevlyde Mezini Saraçi. Jom e lindun më 15 dhjetor të vitit 1954, gjë që njihet si një vit shumë i vështirë kur kishte rënë edhe borë e kuqe. Nga fëmijët e tjerë të familjes time dalloj, sepse nga tetë fëmijët vetëm unë jam lindur në spital dhe pas lindjes familja ime ka përjetu edhe ndërtimin e shtëpisë së re. Kështu që, janë dy gjëra që mua m'bëjnë edhe krenare, po edhe si kurioze. Sepse si nëna ime ka pasur aq shumë dhimbje dhe telashe gjatë lindjes sa u detyrua të drejtoret në spital, ndërkaq të gjitha lindjet tjera i ka pasur më të lehta. Si zakonisht, atëherë në ato kohë të vështira, gratë kanë lindur në shtëpi me ndihmën e zonjave tjera që kanë qenë afër apo të familjes.

Anita Susuri: E bora e kuqe që thatë...

Mevlyde Mezini Saraçi: Atëherë ka rënë në borë e kuqe, ka qenë dimën shumë i vështirë, shumë i rëndë. Ka pasë mungesë të ujit, mungesë të ushqimeve, qarkullim të vështirësuar. Siç tregojnë, një ndër dimrat më të vështirë. Prandaj, edhe jeta ime sikur ka vazhduar me atë ritmin siç kam lindur në dimër të vështirë edhe gjithë jeta ime në të gjitha stinët ka qenë mjaft e vështirë, por unë mendoj se ia kam arritur deri ktu të ia dal me sukses.

Unë jam e lindur nga babi im Halimi dhe nëna Fatimja, të cilën të gjithë e kanë njohur me nofkën Fatushe. Sigurisht se sot unë po flas ma shumë për vetën, sepse sikur të kisha folur për historinë e nënës time, mbase do të duhej një intervistë e veçantë vetëm për jetën e nënës. Sepse ajo ka pasur fatin e keq që babai [i saj] ta lë në moshë shumë të re dhe në atë kohë gratë zakonisht nuk kanë punuar dhe si të reja nuk kanë pasur mundësi materiale t'i rrisin fëmijtë e pavarur. Atëherë nëna është detyruar të kthehet në shtëpinë e gjyshes. Dhe është rritur bashkë me gjyshen, edhe me gjyshen time po edhe gjyshen e saj.

Diku rreth moshës pesë vjeçare gjyshja ime ka qenë e re dhe është detyruar të martohet në mënyrë që ta liroj në barrë për nënën e saj, sepse ka qenë barrë të rritet në fëmijë në atë kohë pa pasur të ardhura. E

kështu që, njerku e ka pranë shumë mirë nënën time, e ka dashur si fëmijën e saj. Por, gjithmonë e shoh si nënë padrejtësi, sepse ia ka ndërruar identitetin, dhe në vend të mbiemrit të saj Matoshi ia ka vu mbiemrin e vet për të realizuar atëherë shtesat fëmimore, të drejtat fëmive. Po edhe sikur ai ka menduar pozitivisht që nëna të jetë e barabartë me fëmijtë tjerë. Por, sidoqoftë, unë e pata borxh ta përmend këtë pjesë të historisë.

Fati i mirë që kur është, nëna ime kur është martuar me babin tim në kohëra shumë të vjetra, janë martuar me dashuri. Kjo ka qenë nifare momenti i kandshëm kur kam dëgjuar për këtë, sepse n'ato kohë ka qenë vështirë të marrësh një njeri me dashuri kur martesat janë bërë me shkuesi dhe të detyrueshme. Prandaj, përveç sakrificave jetësore që ka sjellë jeta, jo vetëm nënës time po të gjitha grave atëherë edhe burrave se ka qenë kohë e vështirë, e varfërisë, kohë e okupimeve. Si zakonisht, si gjithmonë e kemi pasë në okupatorë përmë kokë.

Prindërit e mi kanë kaluar mirë. Kanë kaluar, kanë pasur marrëdhënie të mira bashkëshortore, na kanë edukuar të gjithëve edhe pse kemi qenë tetë fëmijë, për fat të mirë të gjithë të shëndoshë. Shumica të shkolluar edhe pse motrat, dy motrat të mdhajat kanë përfunduar vetëm shkollën fillore dhe nga motra e tretë, e cila sot nuk jeton më, atëherë ka qenë nifare shpërthimi për shkollimin e vajzës shqiptare dhe ka qenë një ndër të parat avangarde, jo vetëm të shkolluar... e ka filluar punën në një librari në Mitrovicë, po ajo ka qenë një krah i fortë për të mbajtur familjen tonë, për t'na blerë libra dhe pajisjet tjera shkollore.

Flas në përgjithësi kemi qenë në familje shumë homogjene, nuk kemi pasë shumë, por edhe nuk na kanë munguar aq shumë gjërat. Kemi pasë në gjendje mesatare, po problemi jonë gjithmonë ka qenë se babai ka qenë ballist dhe ka marrë pjesë edhe ai në luftë. Fatkeqësisht që kjo pjesë e historisë e pa shkruar tani edhe mungon dhe mu më mungojnë shumë informata, por i ruaj kujtimet sepse detyrimisht duhet t'i ruaj kujtimet, sepse jam edukuar në atë frymë. Dhe kam vazhduar gjithmonë aktivitetin duke u bazuar në aktivitetin e babait tim, po sigurisht edhe të prindërve të tij dhe të parëve sepse degët duhet gjithmonë të shkojnë pas rrënjëve. Deshe apo nuk deshe n'atë frymë kur rritesh edhe e përjeton gjithë atë frymëzim dhe edukim që duhet domosdo ta vazhdosh.

Anita Susuri: A ju ka rrëfy ndonjëherë baba ju për përjetimet që ka pasë gjatë Luftës së Dytë Botërore? Kur ka qenë, domethonë, ballist.

Mevlyde Mezi Saraçi: Babai ka qenë ballist para se të lindesha unë edhe ka vazhduar edhe ma tutje. Por unë, me sa më kujtohen, e di se gjithmonë dyrtë tona jemi detyru t'i lëjmë të hapura për t'ardhë policia serbe për ta arrestuar babain në çdo kohë që atyre i tekej apo sidomos para festave kombëtare të 28 nëntorit. Në natë përpara, gjithmonë në shtëpinë tonë kanë trokitë policia për ta penguar babain tim të ndërmarrë ndonjë aktivitet.

Ne kemi mbyllur derën ndonjëherë vonë, në orët e vona, kur kemi dëgjuar Radio Tiranën sepse ka qenë i vetmi frymëzim i joni edhe dritare informimi për atë që ndodhë me popullin tonë përtej kufirit. Dhe sigurisht se ka pasë edhe atëherë bashkëpunëtorë të Serbisë dhe i kanë treguar se ne ndëgjojmë Radio Tiranën, ne bisedojmë biseda për atdheun, për aktivitetet.

Gjithmonë ju kemi nënshtruar një lloj presioni sikur s'kemi qenë të qetë edhe pse jemi munduar ta ruajmë qetësinë shpirtërore, por ka qenë shumë e vështirë. Prandaj une si fëmijë gjithmonë e kujtoj se në derën tonë kanë ardhë njerëz të armatosur, policë të ashpër, të tmerrshëm, dhe gjithmonë e kanë arrestuar babain tim. Dhe pastaj pasi që nuk kanë pasur argumente më vonë e kanë liruar. Por, te ne ka mbetë trishtimi i përgjithshëm.

Anita Susuri: A e kanë keqtrajtu? A ju kujtohet?

Mevlyde Mezini Saraçi: Kujtoj me dhimbje, e kujtoj kto ditë kur nëna e vetme atëherë duhej të kujdesej për neve, kur babai mungonte në shtëpi. Fatkeqësisht dokumentacionin nuk e kemi, se kam menduar që ta bëjë një monografi për jetën edhe veprën e babit tim, por na kanë munguar shumë dokumente që i ka shkatërruar vet shteti serb. Sepse ata përveç që i kanë shkatërruar njerëzit e atdhetarët, e kanë shkatërruar edhe historinë tonë përmes mekanizmave të tyre. Por, sidoqoftë, ne si familje kemi vazhduar traditën dhe me një mënyrë...

Dokument ma t'madh sesa të rritësh tetë fëmijë të shëndetshëm, atdhetarë, njerëz të sakrificës që kanë vazhduar kontributin, unë mendoj që ktu nuk kanë arritur të shkatërrojnë shteti kriminal serb. Dua të flas për nënën, ka qenë një zotë shumë modeste, ka qenë një grua shumë e zonja, ka bërë shumë punë. Ka bërë punë pa dallim, ka baltur pesha. Nuk kemi pasë përpara ujësjellsin përpara si tani që kemi brenda, jo vetëm na po krejt lagja jonë e kemi pasë vetëm një ujësjellës në të cilin kemi marrë ujë për pije.

Ndërkaq të gjitha nevojat i kemi kryer përmes pusit. Me atë kovën, me atë traditën që më dukej si sport. E bojsha si sport duke u arsyetuar kështu sa ta ndihmojmë nënën, sepse ajo ka qenë një grua shumë e pastërt, ka qenë shumë e kujdesshme për familjen. Ajo për çdo ditë i ka larë rrobat tona n'dorë dhe për çdo ditë kemi qenë ndër fëmijë më të pastërt në shkollë. Me gjithë këtë aktivitet e angazhim është dashur ta ndihmojmë natyrisht edhe ne.

Unë e kisha fatin t'jem diku mes fëmijëve, sepse tri motrat e mdhaja tanimë ishin martuar dhe dy vllëzërit e mi po shkolloheshin, edhe unë gjithashtu. Por, përpara ka qenë një traditë, ma shumë vajzat punojnë punët rreth shtëpisë, ashtu edhe e ndjeja të nevojshme. Dhe unë fillova ta ndihmojmë nënën dhe m'ra si barrë e madhe në shtëpi. Mirëpo, gjithmonë duke mësuar, duke lexuar, duke ia zbardhë ftyrën familjes dhe duke u paraqitur sikur nuk e ndjeja lodhjen pasi... n'fund kënaqësia ishte kur punët kryheshin bashkë.

Ne ishim ndër fëmijë më të dalluar në shkollë. E kujtoj edhe mësuesen time të parë zonjën Sadete Mujku- Haxhiu, e cila ende jeton në Mitrovicë dhe e përshëndes. Për atë, ne kemi qenë gjenerata e parë. Ndërkaq unë kom pasë fatin të futem në klasë të parë në shkollën e re. Atëherë ni emër tjetër, por tani osht' ndrru edhe emërtimi i shkollës quhet "Ismail Qemali". Dhe ne fëmijë, si të gjithë fëmijët që i shikojnë mësuesit në sy dhe dojnë ta gjejnë mrekullinë e botës te mësuesit, unë e gjeta tek mësuesja Sadete. Mbështetjen, dashurinë, ngrohtësinë, edukatën, përgatitjen e saj.

Unë, me gjithë këto vite, me gjithë këtë moshë mbi supe, unë m'duket shpesh kur e përmend me ngrohtësi, sikur e ndjej dorën e saj të lehtë mbi flokët e mi, mbi supet e mia dhe gjithmonë thirrjen e saj për secilin prej nesh, "Shpirti i mësuesit!" Asniherë nuk na ka qujtë me emra, për të kemi qenë të gjithë shpirtë. Dhe këto nuk harrohen. Prandaj, edhe kemi pasur frymëzim të mësojmë.

Para se të shkoja në shkollë, unë veç në moshën katër vjeçare kom fillu të shkruaj edhe të lexoj dhe kjo ka qenë ni përparësi e imja. Jo ndonjë afinitet i veçantë, po mbasi gjithë fëmijë tjerë kanë qenë para meje edhe unë kom qenë kureshtare të shikoj se çfarë po shkruajnë apo lexojnë. N' moshën katër vjeçare, unë abetaren e kom mësuar. Kur kam shkruar në klasën e parë, alfabeti nuk ka qenë diçka e re, e kom ditë plotësisht. Kjo më ka ndihmuar mandej që të zhvillohem ma tutje. Por edhe për mësuesen ishte ni krenari e veçantë, sepse bashkëbisedonim si me t' rritur.

Ndërkaq dua të them se frymëzimi im për të shkruar ka qenë shumë i hershëm, qysh në klasën e dytë-tretë kam fillu të shkruaj hartime të shkurta, ese të shkurta, vargje poetike. Dhe atëherë ne kemi mësuar bukur-shkrimin. Nuk kemi mundur ta kalojmë klasën e parë pa e mësuar, jo vetëm alfabetin edhe shkrimin, por edhe bukur-shkrimin. Dhe të gjitha këto poezi apo shkrime që i bojsha letrare, i bojsha në ni fletore të veçantë me bukur-shkrim, të cilat ekspozoheshin çdo ditë për ditën e shkollës në shkollën time. Fatkeqësisht, ato nuk i kam ruajtur dhe për mu do t'ishin ni thesar, se për mu ishin momente të kohës se çka ka ndje ni fëmi, gjëra që nuk më kujtohen sot. Tematikat po, por shkrimet fatkeqësisht jo.

Anita Susuri: Zonja Mevlyde, m'falni që po ju ndërpres nashta. Dashta me u ndalë pak te kujtimet e juja për Mitrovicën, n'atë kohë si ka qenë Mitrovica? E dijmë që ka qenë ni urë në Mitrovicë, po une kom dëgju që shumë shpesh është prishë ajo ura, edhe është ndërtu, ka qenë e drurit. Qysh e kujtoni ju?

Mevlyde Mezini Saraçi: Unë e kujtoj urën e Mitrovicës kur ka qenë vërtetë ashtu ni urë e vjetër dhe kujtoj kur është ndërtu ura e parë e hekurit me ato gozhdat e veçanta, me ato konstruksionet metalike që ka qenë edhe ka mbetë simbol i Mitrovicës. Sepse Mitrovica është identifikuar me dy-tri objekte. Ka qenë ndërtesa, atëherë e quajtur "Jadrani", ku tani ma vonë ka qenë edhe biblioteka, ka qenë qendra, parku në qendër edhe Ura Ibrit të cilët e kanë vizituar vizitorë nga vende të ndryshme. Dua të kthehem edhe në kohën time kur jam rritë.

Mitrovica ka qenë në vend industrial, i zhvilluar. Ka qenë përparimtar, ka qenë në mini Evropë, ka dallu nga qytete tjera. Madje ia ka kalu edhe Prishtinës, sepse zhvillimi ekonomik i sjellë të gjitha këto përparësi. Dua ta them se te ura kom kujtime shumë të bukura. Si fëmi ne laheshim në lumin Ibër, pikërisht në qendër të qytetit. Dhe atëherë, jo vetëm unë, por shumë fëmijë nuk kanë pasur këpucë apo sandale që t'i përdorin edhe për shkollë edhe për lëvizje. Dhe ne nga shtëpia kemi marrë bukën me vete në çanta shpine dhe kemi ecë zbatshur deri, nëpër qytet ku na digjeshin këmbët nga asfalti. Sepse kur nxehej asfalti është shumë vështirë të shkelje me këmbë të zbatshura. Por, ne ashtu të lumtur dhe tërë ditën e kalonim duke u larë. Gjatë pushimeve kuptohet, te Ura Ibër.

I numëronim ato gozhat e konstruksioneve metalike, ato shëlgjet, bonim kërcime në ujë, notonim në ujë, krijonim shoqëri e miqësi të reja, tregonim përralla e tregime, gjëra të ndryshme që më mbeshin në kujtesë si një aromë e fëmijërisë që nuk zhduket kurrë nga shpirti. Por, fatkeqësisht që ajo urë ka përjetu ndryshime gjithmonë, sepse ne gjithmonë në shkollë kemi msu se urat bashkojnë njerëz dhe jemi nisë gjithmonë me atë synim se ura bashkon. Në fakt dy pjesët e qytetit sepse Mitrovica është qytet i ndarë mes për mes me lumë, me lumin Ibër.

Mirëpo, fatkeqësisht që kohëve të fundit po na shuhet kto ëndërra fëmijërore dhe të moshës së re që kam kalu rininë aty. Që Urën e Ibër që e kam kaluar katër vite me radhë për të shkuar në shkollën e mesme teknike, dy e madje katër here në ditë unë nuk mund ta kaloj. Tani shkoj në Mitrovicë boj ndonjë fotografi, derdhi lotë, i bashkohen lotët e mi lumit Ibër dhe kthehem duke kujtuar ato kohë që më mallëgjejnë.

Anita Susuri: A keni qenë në veri t'u jetu apo në jug?

Mevlyde Mezinë Saraçi: Unë kom jetu në pjesën e jugut, në Bair pranë shkollës "Ismail Qemali". Mirëpo, shkollën e mesme e kom kry shkollën teknike, e cila ka qenë në pjesën veriore. Që atëherë si fëmi, kur ka ndodhë mbrëmja, mendoj si nxënës të shkollës të mesme, ne shëtitorët i kemi pasë të ndara fatkeqësisht. Në pjesën veriore të Urës së Ibër, ku kanë qenë dy anët shitorët më të mira të qytetit, aty gjithmonë kanë shëtitur të lirë serbët. Ndërkaq, korzoja jonë ka qenë këndej urës. Pra, në pjesën, në sheshin tani ku është në qytet dhe në rrugën që të shpie për gjimnaz që quhej Çarshia e Madhe. Aty kanë qenë të gjitha dyqanet zejtare, dyqane të bukura, të rujatura të cilat fatkeqësisht shumica janë shndërruar tani në kafiteri apo edhe nuk janë të përdorshme.

Mitrovica ka pasë në imazh të qyteti të vjetër dhe të zhvilluar. Njëkohësisht e ke gjetë të kaluarën edhe po mendoj të tanishmën. Në qytet sikur, sikur nuk jeton, sikur nuk frymon. Ende nuk ka datë të çlirimit, ende nuk feston. Kur gjithë Kosova feston, ne themi se jemi të pavarur edhe se Mitrovica është e lirë ama nuk është Mitrovica e lirë. Mitrovica që nuk ka datë të çlirimit nuk ke ç'ti bësh tjetër pyetje. Por, sido që të jetë njerëzit duhet të përpiqen të vazhdojnë, sepse sovraniteti i Kosovës varet nga fati i Mitrovicës. Nëse Republika e Kosovës arrin ta ruaj sovranitetin atëherë ura që ndanë Mitrovicën duhej

t'hapur sepse nuk është e mbyllur vetëm Mitrovica po është e mbyllur krejt Kosova. Çka të them tjetër për shoqërinë, për...

Anita Susuri: A kishte ndonjë dallim pjesa veriore me pjesën jugore? Apo për njerëzit që jetonin? Serbët? Shqiptartë? Ka pasë edhe të përzimë që kanë...

Mevlyde Mezini Saraçi: Jo, gjithmonë ka pasë dallime pjesa veriore. Ndërtimet kanë qenë më të mira, investimet e Serbisë kanë qenë më të mdhaja, sepse për Kosovën gjithmonë ndahej ni fond për vendet e pa zhvilluara. Në fakt zhvillohej vetëm pjesa përtej Urës të Ibrit. Atëherë nuk kam mundur ta përceptoj si fëmi pse po ndodhë ajo. Dallimet i kemi pa, por nuk kemi mundur ta përceptojmë deri në atë masë që Serbia që herët ka bo politika diskriminuese. Edhe shkollat kanë qenë ma të reja, fakulteti teknik ka qenë lartë, shkolla e lartë teknike, shkolla teknike, shkolla fillore. Të gjitha ato ndërtime të larta që kanë fillu, kanë qenë në pjesën veriore.

Ndërkaq këndej Urës së Ibrit ka qenë vetëm soliteri i kaltërt që quhej, edhe tani quhet i tillë dhe nuk ka pasë ndërtime të larta. Domethonë, të gjitha gjërat me vlerë Serbia i ka ndërtuar, duke... ata kanë pasë plane dhe fatkeqësisht ne shqiptartë vonë kemi filluar të ngritemi edhe të shikojmë se çka duhet të bëjmë. Ata i kanë bërë planet e tyre me Akademinë e Shkencave, ndërkaq Akademia jonë e Shkencave vonë është zgjuar nga gjumi, bile ende nuk është zgjuar në tërësi.

Por, sidoqoftë, unë besoj që ni e arritur e madhe ka ndodhë me lirinë e Kosovës. Me luftën e fundit ka ndodhë ni mrekulli, se Kosova në bazë të Kushtetutës 1974 e ka fitu sovranitetin e vet, po kjo duhet të ndërtohet. Nuk ka përfundu gjithçka, në zhvillim e sipër. Mbase gjenerata ime dhe e juja duhet të punojnë ma shumë që kjo të jetë e përfunduar për gjenerata tjera, sepse kjo histori nuk duhet të përsëritet më. Ky duhet të jetë mësim për neve.

Anita Susuri: E përmendët ma herët shoqërinë, deshtët me folë për shoqërinë, po njikohësisht po du me folë edhe për këtë pjesën e gjimnazit, shkolla e mesme. Po, a ka pasë aktivitete kulturore, për shembull që keni shku, a i keni përcjellë apo a ka pasë dalje? Qysh ka qenë atëherë?

Mevlyde Mezini Saraçi: Po, ka pasë aktivitete. Unë e përmenda ma herët babain që ka qenë edukatori im, nëna po ashtu. Dhe neve fëmive babai na ka lënë ni fjalë që nuk e harroj kurrë dhe e transmetoj te fëmijtë e mi atë e ata te fëmijtë e tyre, "Shtëpia është vetëm për të fjetur". Dhe ai na ka udhëzuar që në shtëpi nuk kemi dobi të qëndrojmë kot dhe na ka dërguar në të gjitha aktivitetet. Për fat të mirë ka pasë shumë aktivitete. Ka qenë grupi letrar i qytetit "Fan Noli". Unë kom qenë anëtare e atij grupi, ni kohë edhe në kryesi.

Kom marrë pjesë në orë letrare, është zhvilluar në ni sallë të madhe afër Shtëpisë së Artmatës. Mandej, ka qenë shtëpia Kej Lushtë, ka qenë shtëpi e kulturës atëherë, te këndi i Lushtës. Edhe tani është në funksion, por pak ka aktivitete. Mandej, në Kryqin e Kuq kam qenë aktiviste ku kemi bërë gara gjatë

vitit disa here. Kam marrë pjesë në korin e shkollës, kam qenë anëtare e grupit të mandolinave, kam qenë anëtare e ansamblit të valleve. Edhe pse vallëzimin nuk kom arritë ta mësoj aq shumë, po kom qenë aktive edhe aty. Por, domethonë, të gjitha këto aktivitete ma kanë plotësuar jetën time dhe unë e kom pa jetën bardhë dhe e kam pa jetën në lëvizje.

Edhe shokët e shoqet kanë qenë gjithashtu shumë aktivë, sepse prej shoqërisë time kanë pasë, domethonë afinitet në instrumente të ndryshme. Dikush ka kënduar, dikush ka vallëzu. Secili e ka pasë atë drejtimin e vet dhe talentet tona i kemi bashkuar për të pasur suksese. Unë jom shumë e lumtur që e kam kryer shkollën teknike edhe në gjeneratë e cila sot e kësaj dite kujtohem si gjenerata e artë, sepse mbi 90 përqind e nxënësve të klasës time kemi arritë jashtëzakonisht në fusha të ndryshme.

Dhe takohemi çdo vit në Mitrovicë, përveç vitit të kaluar për shkak të pandemisë. Takohemi me profesorët tonë të cilët ende jetojnë dhe fatkeqësisht për çdo vit po na zbehen radhët. Megjithatë, ne po takohem, po evokojmë kujtime për të kaluarën. Sepse ta bësh në paralele me shkollimin e atëhershëm me shkollimin e tanishëm është në dallim me të vërtetë shumë i madh. Ka qenë në mundësi e madhe. Kur e kemi përfunduar në vit të shkollës teknike për ne ka qenë si në vit fakulteti.

Ne është dashur ta dijmë lëndën në përgjithësi për ta marrë në note kaluese dhe nëse ke dashur të ngrisësh notën atëherë është dashur të dijshe gati sa profesori. Është dashur të kemi disiplinë, pajisje, punë. Dua t'i kujtoj ato vizatimet teknike të precizuara që kemi pasë, projektimet e detaleve të maqinave, punën praktike në shkollën teknike. Në gjithë bodrumin e shkollës teknike kanë qenë ato, si me thanë, laboratorët edhe punëtoritë në të cilat kemi bërë punë fizike si në punëtor për ta bërë në element i cili ka qenë si detyrë në kuadër të lëndës përkatëse.

Shkolla teknike, dega e maqinerisë ka qenë në degë disi si për mashkuj. Dhe kemi qenë tri nxënëse në atë klasë, dhe në paralalen tjetër kanë qenë edhe katër të tjera. Domethonë, jemi shtatë të parat që e kemi kryer degën e maqinerisë, sepse atëherë konsiderohej punë burrash.

Anita Susuri: Qysh u ndjejshe ju me qenë aq pak femra? Po i bjen në krejt drejtimin veç ju shtatë keni qenë, çfarë ndjenje ka qenë?

Mevlyde Mezini Saraçi: Ka qenë ndjenjë e veçantë sepse neve në fillim na shikonin si femra, si gjini e dobtë dhe t'pamundshme që ta bëjmë punën. Mirëpo, dëshira e madhe, afiniteti, fuqia se t'reja, ne bënim punën shumëfish më mirë se mashkujt. Por, profesorët kanë qenë të ri, të gjithë të shkolluar, domethonë sapo kanë përfunduar fakultetin janë punësuar në shkollë teknike. Dhe kemi qenë gjeneratat ku kemi filluar mësimin shqip, sepse vite më parë ka qenë mësimi në gjuhën serbe, dhe ne kemi pasur fatin që kemi pasur profesora shqiptarë dhe na kanë përkrahë, na kanë dhanë kurajo dhe na kanë ndihmuar.

Gjithashtu duhet të përmendët edhe puna praktike që ka qenë e detyrueshme gjatë verës në minierën “Trepça”. 30 ditë i kemi kaluar në minierën “Trepça”. Tri vite më parë, natyrisht deri në diplomim për të realizuar pranimin në vitin vijues, ka qenë detyrë e jona t’i kryjmë të gjitha ato pjesë teorike edhe në praktikë. Ajo futja në zgafellë, para syve më qëndron ai shkrimi “Me fat!” Kur futeshim me ata ashensorët e thjeshtë, ashensorë të rrezikshëm edhe i shikonim ato koret e tokës edhe kalonim disa shtresa nën tokë. Pastaj ajo dalja në dritë kur gati verbëroheshim nga dielli prej ni errësire të plotë... dhe pjesëmarrja në disa ofiqina e punëtori ku bënim punën, ndërtimin e bulonave. Punë të rënda, gjithmonë me mjete mbrojtëse, ku edhe atje kishim profesorët tanë, por edhe udhëheqësit të cilët na mbikqyrnin.

Gjithsesi në fund e punonim ni material vulominoz deri në 50 faqe me të gjitha atë përvojë ni mujore dhe atë e mbronim pastaj për të kaluar prej vitit në vit. Dhe këto nuk ndodhin sot sepse në shkollën teknike unë jam detyruar për katër vite rresht ta bartë tabelën ni merët me 80 centimetra dhe vizorën Riga T quhej, shkronja T, e cila për çdo ditë duhej për të bërë vizatime teknike në klasë. Pastaj kishim në përdorim ato cirklat, elementet për të bërë harqe të ndryshme, puna me ngjyra, punë precize. Ato tabela që duhet të bëheshin miniature dhe këto... janë gjëra që me t’vërtetë janë mrekulli e kohës por sot pikëllohem pse fëmijët të cilët e kryjnë shkollën teknike, nxënësit në të vërtetë, nuk e kanë atë kënaqësi, atë mundësi, atë kulturë të punës. Dhe në shumë shkolla teknike tani kryhet në mënyrë teorike dhe jo praktike. Thjeshtë, atëherë ne kemi pasë mundësi.

Shkollimi ka qenë në nivel sepse Serbia s’ka mujtë me ndalë shkollimin. Shkollimi ka qenë për të gjithë i barabartë, ndërkaq që ne kemi qenë të favorizuar në atë kohë. Por fatkeqësisht kur ka ndodhë punësimi, atëherë Serbia ka ndërmarrë hapa tjerë. Më shumë janë punësuar njerëzit që kanë qenë favorit për Serbinë, që prindtë e tyre kanë qenë të dëgjueshëm, kanë qenë pjesëmarrës nëpër organe politike, në udhëheqje shoqëro-politike e tjera. Dhe ne kemi qenë në një mënyrë apo tjetër të diskriminuar. Megjithatë, jemi munduar të depërtojmë, sepse shqiptarët në të gjitha kohërat e kanë përkrahë secilën familje që ka qenë e përndjekur. Mandej edhe në mënyrë të fshehtë. Po mendoj, unë kam arritur të marrë pjesë në të gjitha aktivitetet dhe t’i bëjë të gjitha punët.

Anita Susuri: E babai juj me çka osht’ marrë?

Mevlyde Mezini Saraçi: Babai im ka qenë mjeshtër i muratimit dhe ka marrë pjesë në shumë projekte. Madje, madje, shpesh thonte që shkolla teknike ka qenë në mbikqyrjen e tij kur është punuar. Dhe unë e kom pasë fatin pastaj të shkollohem në ato objekte ku gjithmonë më dukej se po i shoh duart e babit, mendimet e tij dhe atë tekniken e tij. Por, fatkeqësisht që babai në ni kohë shumë të hershme është pensionuar si pension invalidor për faktin se ka pasë sëmundje të zemrës. Ka pasë disa here infarkt, i ka mbijetuar por ka qenë i pa aftë për punë. Dhe kjo atëherë për neve ka qenë ni hendikep i madh, sepse janë zvogëlu të ardhurat e babait, dhe në vend se ai të vazhdon të kujdesej për ne, ne jemi detyruar të kujdesemi... pak fizikisht ka qenë i aftë, por nuk ka mundur thjeshtë të qëndrojë gjatë, të ecë shumë. Domethonë, të bartë pesha dhe ne jemi detyruar ato gjëra t’i bëjmë vet. Dhe e kemi ruajtur

dhe për fat ai ka jetuar, i ka kaluar tetë dekata jete me kujdesin të nënës posaqërisht, por edhe të gjithë fëmijëve.

Nëna ime ka qenë autodidakte. I ka njohur tri gjuhë, gjuhën shqipe, turke dhe serbo-kroate. Ka ditë shumëzim, mbledhje, pjesëtim, të gjitha ato. Domethonë, ekonominë e familjes e ka udhëheq nëna. Me nënën kemi ndërtuar edhe tulla për të ndërtuar muret e shtëpisë. Me nënën edhe vllazërit i kemi bërë edhe tullat bashkë, ato format e drurit, e kemi përzi qimentin edhe rërën për të ndërtuar muret e shtëpisë, sepse shtëpia jonë gjendet me një formë vertikale. Në raport me rrugën ka një lartësi diku katër metra dhe përpara të gjitha shtëpitë ishin me mure dhe e jona më vonë. Sepse ishte shtëpi e re e ndërtuar më vonë dhe duheshin mure. Dhe ne nuk kishim mjaft të ardhura sa të shpenzojmë, sepse shkolloheshim të gjithë fëmijët dhe nëna punonte punë fizike duke kursyer babain.

Ndërkaq babai me atë forcën e tij punonte kopshtin. Është interesat se kemi pasë një kopsht shumë të bukur dhe secili prej fëmijëve i kemi pasë llojet e pemëve, domethonë drunjtë, mollat, dardhat, ftonin, kumbullat. Secili që kemi pasur nga një. Pastaj për çdo mëngjes, ne para se të shkonim në shkollë e kemi pasë një obligim familjar të dalim në mëngjes të lajmë faqet, dhëmbët dhe të dalim të vrapojmë stadiumin që është edhe tani, po m'duket tani është ndërtuar shkolla e re. Ka qenë një stadium i lagës tonë dhe kemi vrapuar 500 metra. Për çdo mëngjes të gjithë fëmijët. E pastaj jemi kthyer, kemi bërë një dush, kemi ngrënë mëngjes pastaj kemi shkuar në shkollë.

Shkolla jonë ka qenë afër, zilha është dëgjuar në shtëpi, ajo ka qenë një privilegj për ne. Mirëpo, ka qenë njëfarë edukimi të cilin nuk e hasi sot. Secili prind sot i detyron fëmijët... kur fëmijët tërë ditën rrijnë në telefona dhe nuk kanë kohë të dalin. Dhe sikur m'ka mbetur ajo ecje e mëngjesit edhe tani e tutje e zbatoj. Këto kanë qenë ndër detyrat e prindërve dhe unë menoj që prindërit e kanë bërë këtë edhe për të na edukuar, por edhe mbase nuk kanë pasur mundësi tjetër për të na mbikqyrë. Sepse t'i rrisësh tetë fëmijë me të ardhura të vogla, t'i menaxhosh tërë ditën... atëherë edhe ata sigurisht e kanë gjetë këtë rrugë që edhe sporti është shëndet, por edhe është një kohë, një ritëm i jetës për të cilën na kanë përgatitë për ma tutje.

Ne kur kemi shku në shkollë kemi shku të freskët, diku një orë e gjysë përpara jemi zgjuar. Nuk jemi shku të përgjumshëm, të papërgatitur, por të përgatitur me të gjitha. Pastaj dua ta kujtoj prapë nënën time, e cila në pushimin e gjatë vinte në shkollë dhe na sillte ato kiflet e saj që i përgatiste me duart e saj... në shkollë që ne t'mos mbesnim pa ngrënë, sepse thoshte, "Truri i zbrazur nuk ka mundësi të përformoj" (qan). Kom mallë për ato ditë, por kom edhe dhimbje sepse nëna është munduar shumë. Atëherë si fëmijë sigurisht jemi kënaqur po nuk e kemi kuptuar nëpër çfarë vështirësi ka kaluar. Sa kohë është dashur ajo para nesh të zgjohet që t'na përgatitë të gjitha këto gjëra. Megjithatë, ne e kemi, ia kemi kthyer me dashuri, me suksese, me përkrahje, me mirënjohje, dhe ajo ka qenë ballëlartë kudo që ka dalë me secilin prej nesh.

Pjesa e Dytë

Anita Susuri: Shkollën e mesme që e keni kalu në pjesën veriore me shku, qysh jeni ndje ju? A ka pasë naj lloj paragjykimi prej atyne ndaj jush apo si keni kalu në atë periudhë?

Mevlyde Mezini Saraçi: Paragjykime nuk ka pasë sepse në Mitrovicë të gjithë njerëzit e kanë mrrri ni kulturë evropiane me kohë. Kemi jetu në të njejtin qytet, domethonë në mënyrë të barabartë. Diskriminimi ka qenë tek pasuria. Edhe kështu nuk ka pasë paragjykime, sepse veshja ka qenë gati njësoj. Nëse në treg ka pasë diçka, ka pasë për të gjithë njësoj. Në Mitrovicë nuk ka pasë shumë gjëra të ndryshme nga pjesa e veriut në jug. Domethonë, veshjet... po në shkollë uniforma na ka kategorizue sepse dua ta përmend edhe drejtorin Millan Perka që ka qenë ni atdhetar, ni intelektual, ni profesionist i madh që ka mbajtur disiplinë në ni shkollë me mbi katër mijë nxënës.

Ne nuk kemi guxuar të futemi në klasë pa uniforma. Dhe uniformat tona kanë qenë kecele të zeza me disa pulla deri në bel dhe pjesa e poshtme nuk ka guxue asnjë vajzë apo mashkull të veshë xhinse në shkollë teknike. E kemi pasë të caktuar edhe gjatësinë e fundave apo fustaneve dhe të keceleve dhe gati këpucat uniformë i kemi pasë, edhe pse këpucat nuk kanë qenë të detyruara. Por, kanë qenë disa këpuca sportive të rrafshta me lidhëse që gati shumica e vajzave i kemi pasur të njejtat. Domethonë, atëherë nuk ka pasë rregullime, makijazhe, gjëra, frizura. Kemi qenë të thjeshta sepse ashtu e ka kërku koha, e ka kërku drejtori i shkollës, profesorët. Nuk i kanë lejuar flokët e gjata të djemve, nuk kanë leju pa pajisje të marrim pjesë në mësim, nuk kemi guxuar të ikim nga orët, të mungojmë. Gjithmonë janë lajmëru prindërit.

Kanë qenë disa gjana, disa rregulla. Mbase edhe aty ka pasur shkelje sepse njeriu mund të vishet si të do, por për atë kohë ka qenë ni disiplinë që ne nuk kemi njoftë diçka ndryshe dhe jemi pajtu me atë. Kemi kujtime t'mira për atë kohë, sepse edhe shokët e shoqet janë kujdesë për neve, domethonë nuk ka pasë ngacmime. Ndonjëherë jemi ngacmu me nacionalitete tjera verbalisht, por rrallë jemi ngacmu apo jemi rrahur sepse gjithmonë jemi mbrojtur nga ajo ndjenja se duhet të shkojmë në familje dhe tregojmë kujdes, jo që kemi bërë ekscese. Edhe pse ka pasë momente të tilla.

Ne kemi pasë paralelet serbe afër klasës dhe i vetmi dallim që ka qenë me neve, ato kanë ardhë të pregtitura, të shminkuara në mësim, serbet. Ndërkaq ne kemi qenë më të thjeshta. Këtu e shoh dallimin, përndryshe diçka tjetër jo. Unë e shoh dallimin që edhe profesorët të cilët kanë qenë serbë në shkollë teknike nuk kanë bërë dallime ndaj nxënësve. Sepse jo që ata nuk kanë pasur dëshirë, por drejtori i shkollës ka qenë shqiptar, që thashë, dhe ai ka pasë rregulla. Te ai nuk ka pasë përjashtim te asni nacionalitet, për të gjithë profesorët ka qenë i rreptë, i drejtë dhe ka marrë masa. Prandaj edhe kjo kohë ka kalu ashtu.

Edhe pse kur jemi kthyer n'shpi na kemi bërë biseda me prindërit, me babain, me vllazërit, me motrat, kemi bisedu për gjërat e ndryshme. Për mungesën e lirisë, sepse mungesa e lirisë ka qenë gjithsesi prezente në secilën familje. Nuk e di a ka familje shqiptare, gjatë rritës time apo edhe më përpara apo më vonë që nuk ka pasë të diskriminuar në familje, të përndjekur, të burgosur. Thjeshtë ne jemi detyruar në shumë momente të heshtim, të vërtetën ta mbajmë në brendi, të kënaqemi me një flamur që e vizatojmë brenda për brenda në shtëpi, të lexojmë vargje të shkrimtarëve të ndaluar duke i fshehur librat.

Unë e kujtoj edhe një libër të Enver Hoxhës. Atëherë ne kemi pasë, Shqipërinë e kemi identifikuar me Enver Hoxhën që kishte qenë gabim, por ne nuk kemi ditë ma tepër. Kur vllau im e mbyllte librin dhe nuk na lejonte të lexonim, ne kishim kërkues të kuptonim më tepër për Enver Hoxhën, që kom arritë shumë pak atëherë të marrë vesh sepse ai ka mbyllur nga frika se ne mund të flasim përjashta dhe gjithsesi vllau do të burgosej.

Anita Susuri: E qysh keni arritë m'i pasë qato libra? Kush i ka prurë ato? A qysh kanë qarkullu?

Mevlyde Mezinë Saraçi: Eh, po, komunikimi ka qenë me këto vijat e tresheve. Unë e kujtoj edhe një kasetë të cilën e kam dëgjuar fjalimin e Adem Demaçit, që unë atëherë nuk kam pasë ide kush osht' Adem Demaçi, si fëmijë. Po vinte daja i cili edhe ai ka qenë në aktivitete t'ndryshme me grupin e tresheve siç janë njohur atëherë për lëvizje, në lëvizje për shkrimin e Kosovës. Dhe në mënyrën ma të fshehtë na ka transmetuar. Dhe unë ende i kujtoj fjalët dhe atë zërin e zotit Demaçi, tanimë i ndjerë, heroit të Kosovës. Por, atëherë, nuk disha, u frymëzojsha pa e ditur historinë e atij njeriu i cili kishte kaluar shumë vite nëpër burgje.

Më vonë pata fatin që të bashkëveproj dhe të jetoj edhe në kohën e Demaçit, në përpjekje të vazhdueshme për liri e pavarësi. Prandaj, ka pasë lëvizje, ka pasë. Edhe "Mesharin" kemi arritë ta kemi në shtëpi, por duke bartur dorë mbas dore. Kemi arritur edhe shkrime të ndryshme të kemi dhe gjitha këto janë bërë në mënyrën më të fshehtë. Unë kom pasë fatin t'i kem edhe dy vllazërit e mi më të mëdhej se unë të cilët po ashtu kanë pasur një shoqëri të pastërt, të frymëzuar dhe... po pse mos t'a përmend edhe kohën kur shpërtheu, shpërthyn demonstratat e '68-ës. Babai im ka qenë pjesëmarrës në demonstrata në Prishtinë.

Tani është përmendorja e Zahir Pajazitit dhe po aty ka qenë stacioni i autobusave. Dhe babai im nuk ka qenë organizator, sepse nuk dua të bëjë gjëra që nuk kanë qenë. Por, ai ka qenë në Prishtinë, ka qëlluar në momentin kur kanë shpërthyer demonstratat dhe ai ka marrë pjesë. Atëherë ka përjetuar rrahje, por nuk e kanë arrestuar për faktin se nuk ka qenë në listën e njerëzve. Por, ai ka marrë pjesë dhe nuk ka mundur të kthehet në Mitrovicë për një javë ditë. Ka qëndruar në Prishtinë te motra sepse janë përndjekur të gjitha figurat që kanë marrë pjesë.

Prandaj, siç e shpjegonte ai atëherë dhe si e shoh tani në fotografi e dokumente dhe materiale filmike, vërtetë më duket sikur unë e kam përjetuar demonstratë kur janë djegur autobusë, kur janë rrahur njerëz, kur janë plagosur, dhe gjëra të tjera. Dhe pas kësaj menjëherë sikur u lirua edhe mund të frymonim më lirshëm. Pastaj dua ta kujtoj vitin '74, në vitin '74 kur u aprovu Kushtetuta e Kosovës si pjesë e barabartë, pjesë konstitutive e federatës që pikërisht Republika e Kosovës i ka bazat në Kushtetutën e 1974-tës. Sikur të mos ishte ajo Kushtetutë, Kosova më vështirë do ta kishte... edhe pse e kemi pasur shumë të vështirë, kemi dhënë shumë.

Megjithatë, baza që na ka ndihmu ndërkombëtarisht ka qenë Kushtetuta e vitit '74. E pse jo të mos e kujtoj profesorin Hajzer Hajzeri kur erdhi në orën e historisë dhe na shpjegoi për kushtetutën. Hera e parë që kom ndëgjuar fjalën kushtetutë dhe e kam kuptuar çka është kushtetuta me atë memorien time si nxënëse. Por, ai na ka frymëzuar, ka qenë ni atdhetar i jashtëzakonshëm na ka treguar se nga sot ne shkelim në këmbë, jemi vertikalisht më të fortë. E çka ndodhi pastaj në shtëpinë time?

Sigurisht edhe vllazërit në shkollë nga profesorët e tyre janë frymëzuar dhe që të dy kanë marrë ngjyrat dhe para 28 nëntorit, e cila siç thashë [shtëpia] ka qenë e ndërtuar në lartësi prej pjesës së asfaltit ku kanë kaluar qytetarët dhe kemi pasë hyrjen dy shtylla t'pambyllura, ka qenë si pjesë e hapur ajo. Dhe në njërin nga shtyllat, 80 me 50 centimetra e kanë vizatu shqiponjën, formën e flamurit. Unë i kam ndihmuar, por nuk e kam kuptuar deri në fund çka se dikur m'ka marrë gjumi. I kom përgatitë ngjyrat, i kom dërgu deri te vllau, i kom ndihmuar ta mbajë karrigen, por nuk e kam parë përfundimin e atij vizatimi.

Në mëngjes, herët në mëngjes kur kanë trokitur dyert, janë përplasur nga policia serbe. Jam zgjuar nga gjumi i kam pa çizmet e policisë te fytyra. E kanë arrestuar babain, i kanë arrestuar vllazërit e mi, i kanë dërguar në mbajtje disa orëshe për t'i marrë në pyetje. Ndërkaq thjeshtë babai im nuk ka pasë të bëjë atë natë me vizatimin, por ka pasë të bëjë me frymëzimin natyrisht. Dhe nuk e harroj këtë moment. Por, për neve ka qenë me rëndësi se qindra njerëz të lagjës kanë kalu në mëngjes duke shkuar në punë dhe sigurisht janë kënaqur kur e kanë pa. Po sigurisht ka pasur edhe të tillë që e kanë lajmëruar. Sepse përpara ka qenë ni lloj, nëse nuk e ke bërë je përgjegjës nëse nuk e lajmëron. Kjo ka qenë për njerëzit labil të cilët nuk e kanë dashur atdheun, nuk e kanë dashur kombin. Por ne e kemi përjetuar edhe këtë.

Unë sa herë shkoj në shtëpinë e lindjes sikur m'duket se e shoh atë vizatim, atë shqiponjë dy krenare me atë fushën e kuqe dhe vizatim të punuar nga durtë e arta të vllazërve të mi. Pastaj, pas asaj kohe kemi qenë vazhdimisht të përgjuar nga policët serbë edhe shqiptarë. Se atëherë kanë punuar edhe inspektorë shqiptarë, të cilët më vonë janë diskualifikuar dhe kanë mbetur të anashkaluar, edhe pse jo të dënuar të cilët kanë jetuar jo vetëm në lagjën time po në mbarë qytetin.

Anita Susuri: E me shqiponjën e vizatime çka ka ndodhë? E kanë ngjyrosë përmbi? E kanë heqë?

Mevlyde Mezini Saraçi: Shqiponjën, jo që e kanë ngjyrosë, por i kanë detyru vllazërit që ta grryejnë atë pjesë dhe ta bëjnë në shtresë të re të mbyllët sepse shtylla ka qenë e bardhë. Pasi i kanë liruar vllazërit, i kanë detyruar. Shqiponja ka mbetur ashtu për krejt kohën sa kanë qenë vllazërit brenda. Kjo, ky mbetet në kujtim që sa herë takohemi, sepse tani të gjithë jemi larg njëri tjetrit, na ndau jeta. Dhe verës kur takohemi shpesh e bisedojmë dhe i përjetojmë emocionet e njejta sikur atëherë.

Anita Susuri: Në vitin '74 ju keni qenë në shkollë të mesme apo? A po i bjen qashtu?

Mevlyde Mezini Saraçi: Po.

Anita Susuri: Pastaj keni vazhdu ma tutje?

Mevlyde Mezini Saraçi: Pastaj, unë, ishin dy rrugë. Isha në një moshë kur fillova të dashuroj edhe dy dashuri në dy kahje të ndryshme. Shkollimin, por edhe Agimin (qeshë). Dhe kështu ndodhi që ishin kohë të vështira që të dyja nuk mundja t'i bëja përiherë, sepse Agimi jetonte në Gjakovë. Ndërkaq unë duhej të shkollohesha në Prishtinë. Dhe vendosa të martohem të shkoj në Gjakovë me kusht që unë t'i vazhdoj studimet në gjuhë dhe letërsi. E gjuha e letërsia, krijimtaria kanë qenë dëshirë e imja, jo profesion. Por, unë e bëra profesion sepse u mundova që t'i lidh dy dashuritë dhe unë t'mos i, t'mos e pengoj vetëveten thjeshtë sepse ishte e pamundur të dy rrugët.

Rrethanat ishin të tilla që vajza e dashuruar të martohet apo të shkollohet, njërin (qeshë). Unë nuk munda të heqë dorë. Dhe për fat të mirë atëherë në Gjakovë e bëra Shkollën e Lartë Pedagogjike Gjuhë dhe Letërsi që ma tutje vazhdova edhe fakultetin dhe e mora titullin...

Anita Susuri: E qysh jeni njoftu me bashkëshortin?

Mevlyde Mezini Saraçi: Po të them të drejtën, bashkëshorti im e ka pasë dajën afër meje, fqinj. Ne kemi qenë shumë të lidhur me ata dhe natyrisht ai çdo verë ka ardhë. E kom njohur shumë vite më parë, as që kam menduar që nesër, masnesër do të jetë, si me thanë, bashkëshorti im dhe bashkë (qeshë).

Anita Susuri: Bashkë udhëtari.

Mevlyde Mezini Saraçi: Bashkë udhëtari i jetës, por që ka qenë fat i imi ashtu.

Anita Susuri: A keni lëvizë brenda Kosovës, për shembull, a keni qenë me vizitu vendet tjera? Se për shembull Mitrovica ka qenë si qytet ma i zhvillim, por Gjakova e ka pasë nifarë zhvillimi t'vet po ka qenë, po mendoj, ma e prapambetur sesa Mitrovica si qytet. Si iu është dukë juve?

Mevlyde Mezini Saraçi: Po, unë kur jam martuar në Gjakovë ma së pari kom pasë problem me dy kultura të ndryshme. Jom rritë në një frymë tjetër, në një frymë shumë bashkëkohore edhe ku gruja ka

pasë shumë përparësi si sot që kemi mrri shumë fusha të ndryshme. Ndërkaq, në Gjakovë shumica e grave kanë bajtë barren e familjes. Kanë punu punë dore, daljet kanë qenë të kufizuara. Mbasi shumë shpesh qeshim se për të shkuar diku është dashur të pytet krejt lagja në fund të merrej një vendim. Por unë kam pasë fatin që të takohem me ni familje bashkëkohore, tipike shqiptare, jo të them në thojza tipike gjakovare t'jem e mbyllur dhe gjithmonë e kam pasur ni përparësi.

Familja e Agimit kanë lëvizur në Mitrovicë për te daja, sepse daja i Agimit ka marrë pjesë në Luftën Nacional Çlirimtare dhe ma tutje ka mbetur në Mitrovicë si figurë, domethonë eminente dhe këta kanë lëvizë shpesh sepse e kanë pasur njeriun ma të afërt. Sikur kjo lëvizja e ka bërë t'vetën dhe, po edhe shkollimi i djemve, i vllëzërve të Agimit, shkollimi i Agimit e kanë bërë t'vetën që unë e kom pasë ma të lehtë në atë familje e pse jo edhe në qytet. Sepse unë kur kom dalë me veshje siç jemi veshë në Mitrovicë në Gjakovë është dashur ni veshje pak ma e mbyllur. Daljet e mbramjes ma shumë kanë dalë mashkujt, ma rrallë kanë dalë femrat.

Unë kom qenë e re se unë u martova e re dhe menjëherë fillova ta themeloj familjen. E linda fëmijun e parë, të dytin e kështu. Dhe unë për çdo natë isha në korzo. Isha me të gjitha do elementet që i takojnë ni personi. Pastaj u punësova unë menjëherë atje edhe pse vazhdova shkollimin, u punësova. Ishte ni pavarësi. Sepse në mëngjes nëse nuk ke ku të shkon, nuk je e pavarur të dalësh. Dhe unë e kisha ni detyrë, mandej krijoja të ardhura. Me ato të ardhura normal që duhet të furnizoja shtëpinë, të kujdesem edhe për blerje, për veshje. Po kemi lëvizur shumë.

Unë kom pasur fatin të lëvizë, për Kosovë gjithsesi. Meta borxh të them që edhe fëmijëria ime karakterizohet jam rritë baraz në Mitrovicë edhe në Prishtinë. Madje, madje kur e shoh sheshin e Prishtinës, ma i bukur ka qenë atëherë se tani. Tani është shumë i shëmtuar. Ka qenë më i pastër, më i ruajtur. Kom kujtime fëmijore kur lojnat e fëmive i kom përjetu në sheshin ku është tani. Ku lëvizin makinat, ku ka papastërti, ku është e mbushur me lypsarë, me kiosqe, me trafikantë, me çkado tjetër. Mbase, ajo lëvizja ime si fëmi m'ka ndihmuar pastaj edhe nga Gjakova të lëvizë.

Prizrenin e kom pasë dashuri që e kom edhe sot edhe pse ni vend që të mbush frymëzim. Në Prizren jom furnizu me rroba nga më të ndryshimet, ka pasë ni tregti, jashtëzakonisht e fuqishme ka qenë. Pastaj në Pejë kemi lëvizur shpesh edhe për klimën e bukur, Rugovën e Pejës, por edhe qytetin e Pejës. Pastaj Peja ka pasë, është shquar nga tregtia për këpucë moderne, për njerëz të mirë, njerëz të butë, intelektual. Domethonë, në secilin qytet kom gjetë diçka.

Pastaj, kom lëvizë edhe në ish-Jugosllavi, sepse rrethanat kanë qenë të tilla nuk ka pasë kufi. Nëse një njeri ka pasë të ardhura ka mund të lëvizë, që atëherë kom pa Beogradin, Zagrebin. E pushimet i kemi bërë në Ulqin, domethonë Mali i Zi, Ulqini edhe ai ka qenë ni shtet tjetër. Kom lëvizë në Bosnje, kom lëvizë shumë edhe ma përpara po edhe pas luftës, sepse sikur krijuesit e kanë dashuri edhe udhëtimin. Dhe unë i përceptoj gjanat ashtu, nëse e vizitoj ni qytet fitoj frymëzim për ni kohë të gjatë, jo vetëm të shkruaj po edhe të jetoj. Po kom lëvizë.

Du ta përmend edhe ni çështje që unë jom gruja e parë që kom veshë xhinse në Gjakovë. Dhe mbase shumë njerëz e kanë mbajtur gojën me duar, por unë kom pasë përkrahjen e familjes (buzëqeshë). Mandej e kom pasë ni shoqe në Shkup, në korzën e mbrëmjes atëherë nuk kishim telefonat të bonim fotografi por flisnim dhe i tregonim se si jam veshur në mbrëmje në korzo. Edhe pse unë gjithmonë jom veshur thjeshtë, po ajo thjeshtësia është më e bukur se çdo gjë. Dhe në mëngjes kom marrë komente nga shoqja ime nga Shkupi, e cila thoshte se, “Mbrëmë ke shkëlqy në korzo”, “Jo more unë jom frymëzu pse kom qenë me bashkëshortin, me fëmijët”, sepse të gjitha lëvizjet pastaj i kom bërë me fëmijët. Asnjëherë nuk kom shku aty ku shkojnë të rriturit dhe nuk kanë mundësi të kënaqen fëmijët. Por, i kom ndalu kënaqësitë e mija për të bashëjetuar ato bukuri, ato kënaqësi, ato përjetime bashkë me fëmijët e mi.

Mbase te Pallati i Kulturës ka qenë ni park shumë i bukur i cili vetëm mund të mbetet fotografia sepse nisoj si Gjakova që e ka sot parkun karakterizohet edhe me sheshin e Prishtinës. Edhe pse po ndërtohet ni park i ri, po flas për t’vjetrin. Ka qenë me oaza të bukura, me pemë dekorative, me lule shumë ngjyrëshe. Dhe unë i merrja fëmijët dhe nën ato kaqubet, merrnim ni batanije uleshim aty dhe bisedonim me fëmijët sepse Mitrovica ishte pak ma larg dhe nuk mund të shkoja çdo ditë dhe i thoja fëmijëve, “Ne po dalim ni shëtitje”, që ishte 200-300 metra larg shtëpisë. Por e përjetonim thjeshtë ni shëtitje të bukur, dy-tri orë të bukura. Ni akullorë që ka qenë traditë e Gjakovës për ta marrë në dorë te ajo familja Kurtishi që e ka pasë ni kioskë të vogël, gati tetë gjenerata, po mendoj tetë dekada dhe ajo ka qenë ni karakteristikë e thjeshtë. Shpenzime të vogla, por kënaqësi të momentit. Këto kanë qenë lëvizjet e mija.

Kom qenë notare e mirë sepse siç thashë jemi rritë te lumi edhe në ni qytet me lumë kur prindërit e përkrahin natyrisht, ke mundësi me mësu edhe notin. Dhe kur shkonim të laheshim në Dri me bashkëshortin, shikoja vetëm mashkuj. Mirëpo, unë isha e shoqëruar nga bashkëshorti. Notonim në atë grykën e Drinit dhe ishte kënaqësi. E kalonim ditën. Udhëtonim me bicikleta, e kom vozitë bicikletën shumë kohë. Edhe tani por pak mosha pak pesha. Domethonë, kom kry shumë aktivitete edhe me bicikletë që atë kohë nuk kanë qenë shumë të kandshme për gra, por unë i kom përjetu.

Dhe çka ndodhë në Gjakovë? Për ni dhetë vjetësh ndodhi ni mrekulli. Filloi ni dalje masive e grave, filloi ni lëvizje e bukur, qyteti ndryshoi, kultura ndryshoi. Po mendoj Gjakova ka tradita t’mira që i ruan edhe sot, por për grate ndodhi ni mrekulli. Atëherë unë frymova lirshëm dhe u ndjeva e barabartë dhe më nuk kishte ndryshim nga Mitrovica apo Prishtina, por ishte ni jetë shumë e bukur ku gratë ndërmorrën shumë gjëra, shumë iniciativa, shumë aktivitete. Përfundun edhe shkollimin për të vozitur edhe makinat, në pushime shkonin më shpesh, në Dri laheshin gra, më shumë shikonim gra sesa burra. Domethonë, ndodhi ni ndryshim shumë i bukur. Sigurisht zhvillimi ekonomik solli edhe këto gjëra.

Anita Susuri: Në cilin vit ju jeni martu?

Mevlyde Mezini Saraçi: Viti '75.

Anita Susuri: Domethonë n'atë vit në '75-ten në Gjakovë ka pasë ndoshta gra të mbulume me pexhe, a kanë lëvizë ashtu?

Mevlyde Mezini Saraçi: Unë nuk kom pa gjithsesi të mbulume të gjitha, sepse në Gjakovë pexhën e kanë heqë ma herët. Ka pasë me shalla po me ato traditat, jo t'them fanatike fetare. Por, jo të rejat kanë qenë të zbuluara edhe atëherë nuk kanë qenë të mbuluara. Por, dalja ka qenë disi e kufizuar. E pastaj jo, sepse grate në Gjakovë kanë punu shumë. Edhe që kanë qëndruar në shtëpi kanë punu punë dore. Por, pastaj me ato fabrikat që kanë qenë në Gjakovë janë punësu shumë gra dhe, edhe zhvillimi ka ecë.

Unë, për shembull, vjehrrën time e kom pasë të lindur në vitin 1916 dhe vjehrra ime ka qenë bashkëkohore. Ajo ka pasë veshje moderne, ka shku n'punë, e ka udhëheqë ni njësi të punëtorëve, ka pasë të ardhura, ka shëtitë, ka shku në pushime, kemi dalë mbrëmjeve. Siç thashë, kemi shëtitë edhe në komuna të tjera. Dhe ato daljet në Prizren i kujtoj shpesh në Urën e Gurit me vjehrrën (buzëqeshë), sepse kishte dëshirë shumë të shkonim atje dhe të bënim fotografi.

Atëherë fotografija bëhej rrallë me ato aparatet klasike edhe çka të kujtoj... Urën e Gurit e kujtoj me vjehrrën. Po dua të them që vjehrra ime ka qenë ni akademike edhe pse autodidakte. Ajo ka njoftë shumë mirë historinë, gjeografinë. Më ka tregu shumë për Gjakovën, për figurat kryesore. Pastaj për ato, të them, gabimet e vogla që i kam bërë se s'i kam ditë rregullat e Gjakovës. Ajo gjithmonë m'ka arsyetuar se, "Kjo është nga Mitrovica dhe nuk ka nevojë, nuk i din", dhe gjithmonë m'ka ulë pranë vetës, sikur engjëll mbrojtës ka qenë për mua. Dhe unë këtë e kam kalu.

Pastaj, Agimi gjithmonë ka qenë njeri i kuptueshëm, bashkëkohor. Kom kalu mirë me familjen e tyre. Nuk kom pasë ndonjë problem që unë t'pengohem në të gjitha lëvizjet. Kom udhëtu në Mitrovicë, kom udhëtu në takime të ndryshme, kom qenë aktive kudo. Po e vetmja gja që më mbetet peng që nuk kom mujtë të publikoj libra deri në përfundimin e luftës, sepse disi kom qenë halë në sy për pushtetin si bijë e Halim Mezinit edhe pas martesës. Dhe disi nuk kam mundur të depërtoj aq shumë pa përpjekje të mëdhaja për të dalë në skenë.

Mirëpo, nuk jom vonu, besoj që nuk jom vonu. Shumë poezi që kam shkruar, që kam rritë fëmitë me poezi, sepse nëse ndonjëherë jam pikëlluar për ndonjë gabim të vogël apo sjellje të fëmive, unë nuk i kam ndëshkuar. U kam shkruar disa vargje, u kam mësuar dhe ata përmes vargjeve kanë kuptuar hidhërimin tim. Dhe këto poezi i kam ruajtur dhe kam botuar në librin e parë "Sytë e Pranverës", edhe "Kur jeta duhej jetuar", të dytin. Në të dy librat i kam përfshirë ato poezitë që kam shkru vite përpara. E tani me dalë te lëvizja, aktivitetet, njeri ka çka të flet. Me të vërtetë jeta ime është e mbushur me aktivitete dhe shpesh unë filloj dhe nuk di nga të vazhdoj, sepse në secilin moment të jetës, në secilën stinë të jetës kam diçka.

Pjesa e Tretë

Anita Susuri: Kur jeni punësu? Kur keni fillu, domethonë, me shku n'atë drejtim jetësor?

Mevlyde Mezini Saraçi: Po, unë jom punësu meniherë pas martesës, sepse jam punësu me shkollën e mesme teknike që kam përfundue. Edhe për mu ka qenë ma lehtë në organizatë, sepse në organizatë nuk jam përndjekur shumë. Edhe pse unë jam përndjekur mjaft edhe aty, sepse kam qenë element destabilizues. Por, pavarësinë e kom kriju meniherë, sepse kom qenë bursiste e “Trepçës”. Përpara kemi pasë përparësi në shkollim, sepse në degët teknike “Trepça” na ka ofru bursë të gjithëve, dhe secili nxënës që ka arritë ta përfundoj me sukses vitin ka vazhdu.

Meqenëse si bursiste e “Trepçës” kam kërku të punësohem. Atëherë “Trepça” ma ka mundësu në degën e vet në Gjakovë të më punësoj. Atëherë ka qenë fabrika “Fundolija”. E pastaj si profesoreshë e gjuhës tek pak para luftës kom arritë të punësohem sepse ka qenë vështirë. Ka qenë vështirë të depërtosh në arsim, sepse punonjësit e arsimit janë shikuar me një llupë ndryshe nga sistemi i asaj kohe. Megjithatë, kom mbërri ta përfetoj edhe rolin e arsimtarës, të punoj në shkollën “Gjergj Fishta” në Bishtazhin, t'i edukoj nxënësit edhe pse nga aty pastaj kam përfunduar në një formë tjetër. Për shkak të aktiviteteve pastaj edhe jam burgosur.

Po po flas për organizatën ku kam punuar. Në vitin '81 unë isha shtatzënë. Isha në muajin e katërt të shtatzanisë me vajzën time, tani quhet Heorina. Dhe ndodhi demonstrata e madhe dhe unë n'atë kohë i ndihmova demonstruesit t'i strehoj, t'ju japë ujë e ushqime dhe posa dolën... në punë vjehrra ime më luti, tha, “Të lutem Mevlyde, mos shko të hënën në punë sepse të kanë identifikuar, të kanë lajmëruar. Tani je shtatzënë, është edhe vajza, i ke edhe dy fëmi tjerë të vegjël dhe unë jam e moshuar çka do të bëjë”, thashë, “Unë do të dalë edhe të mos dalë në punë”.

Fati im po atë ditë u bë mbledhja e tubimit të punëtorëve dhe na erdhi një njeri i komitetit ni shqiptar me gazetën, “Zëri i Kosovës”, në të cilën Shqipëria i kishte dënu demonstratat e vitit '81, sistemi i atëhershëm. Edhe po më thonë që, “Mund ta marrësh ta lexosh”, për shkak të afiniteteve të mija edhe drejtimit që kisha, thashë, “Nuk mund të lexoj sepse po më dhemb fyt”, nuk e pranova. Si mund ta lexoja unë atë tekst kundër protestuesve.

Pastaj njëri nga organizatorët e atij takimi, domethonë, punëdhënësi tha, “Po mirë atëherë, ti ki ni shkrim të bukur teknik dhe ti do ta mbash procesverbalin”, thashë, “Nuk do ta mbaj se jam shtatzënë dhe nuk dua t'marrë përgjegjësi ta ngarkoj anën psikike, mu m'duhet ni qetësi. Unë jam këtu.” Dhe ata e kuptuan. Pastaj filloi diskutimi dhe filluan pjesë-pjesë punëtorët të frymëzohen, disa për, disa kundër demonstratave dhe unë e mora fjalën pa një pa dy.

Unë harrova vetën time sepse gjithmonë kam vujtë dhe pse të mbrohesha atë ditë. U ngrita në këmbë thashë, “Si s’ju vjen turp, flisni shqip dhe kërkon t’i dënoni demonstratat. Ti zotëri me flokë kaqurele, mund t’na hedhësh neve? Jo. Ata kanë të drejtë, të gjithë kanë të drejtë. Ne duhet t’i përkrahim”. Ai u ngrit në këmbë u tërbua, tha, “Si quhesh ti zonjë?” Thashë, “Mevlyde Saraçi”, tha, “Ku banon?” Thashë, “Aty ku kam banuar gjithmonë”, tha, “Ma jep adresën”, thashë, “Po. Sadik Stavileci 122”, tha, “Ma jep edhe numrin e telefonit”, thashë, “Urdhëro edhe numrin”. “Tani”, tha, “qëndro në shtëpi, pasdite do të vij në të marrin, do ta paguash”.

Më besoni, nuk kanë kalu disa minuta ka përfundu ai takim. Unë kom shku në zyrën time, kam qenë referente e lartë për mbrojtje higjieno-teknike dhe jam qetësuar, nuk kam menduar për ma tutje. Vetëm kam menduar si do ta vazhdoj jetën në burg, si do ta lind fëmijën. Atëherë nuk e dija a do të lind vajzë apo djalë, sepse atëherë nuk i hulumtonim të ardhmen e lindjes. Por, mendoja për vetën si do të mbrohem tani, se e mora ni përgjegjësi gjithsesi.

Përfundoi orari i punës, shkova në shtëpi. Sa shkova erdh vjehrra dhe tha, “Pse moj nuse?” Ajo kishte marrë informatën, informata kishte bërë jehonë në të gjithë qytetin. Pas pak çastesh erdhi edhe Agimi nga puna tha, “M’treguan se kështu kështu...” thashë, “Nuk t’paskan tregu krejt, po mos u shqetëso. Unë fmijën n’bark do ta marrë me veti do ta lind edhe në burg, ky do të lindë. Ju kujdesuni për këta. Dy veta jeni secili për nga njërin edhe Diamandin edhe Rrezartën, dhe unë për fminë që e kam n’bark do të kujdesëm. Ai do t’lindë edhe nëse më vrasin fëmija do të lind”.

Po pastaj në Gjakovë e kanë njohur njëri tjetrin dhe sigurisht ka pasur njeri human, atëdhetar që ka punu edhe n’atë kohë në Sekretariat. Kur e kanë marrë vendimin për të ardhur në shpi për të më arrestuar, dikush nga udhëheqësit ka reaguar. Ka thënë, “Si s’ju vjen turp ta merrni një grua shtatzënë kur të gjithë, të gjithë punëtorët janë çu kundër e ju vetëm atë. Po çka ka thanë? Ka të drejtë, e tjetër?” “Po, po ajo ka tri vija të kuqe sepse edhe rastet tjera kështu ka tregu interesim për çashtje kombëtare, ka bërë diçka tjetër edhe kështu me radhë”. Edhe unë prita, prita, më morën vetëm bisedë informative edhe shpëtova asaj radhe nga burgu. Edhe pse gjithmonë e përndjekur.

E pas kësaj pastaj ndodhi viti ‘89 në themelimin e lëvizjes mbarëkombëtare, Lidhjes Demokratike të Kosovës, ku dola u regjistrova ndër anëtarët e para. E pastaj 7 marsi, dita vendimtare ku unë kom vazhdu, po e them kom vazhdu ni aktivitet të filluar më herët si fëmi po kam fillu ni aktivitet në ni formë tjetër si grua, si nënë, si atëdhetare, si veprimtare me themelimin e Forumit të Gruas të Lidhjes Demokratike të Kosovës. Jam ndër 15 gra që kemi marrë përsipër udhëheqjen e degës në Gjakovë dhe po ashtu kjo ditë m’ka kushtuar menjëherë me marrje në pyetje të nesërmen në organizatë.

Anita Susuri: Si kanë qenë këto bisedat informative? Si janë zhvillu?

Mevlyde Mezinë Saraçi: Bisedat informative kanë qenë biseda me ngarkesa psiqike, të kanë ofruar bashkëpunim me Serbinë për me heqë dorë nga interesat kombëtare, të kanë ofru vende pune, para,

për ta ndrruar qytetin, për të jetu diku tjetër vetëm për të mos... mirëpo, nuk kom pranë sepse unë nuk kom zgjedhë mënyrë tjetër të jetesës. Unë kom pasë qytetin e lindjes edhe qytetin ku kom jetu Gjakova. E kom pasë shtëpinë, bashkëshortin, fëmijët dhe nuk kom pasë nevojë për më tepër sepse unë me atë punën time kom realizu mjaft të ardhuna sa për të jetu. Jo për ndonjë lluks, por kemi jetu ni jetë normale. Sepse në mu është ndërtu diçka brenda si fëmi dhe ajo që osht' ndërtu, ajo dëshira e flaktë për liri nuk ka mund të shuhet nga çfarëdo shume monetare apo luksu të cilin e kanë ofru ata.

Ka pasë shumë gënjeshtër që kjo shoqe apo ky fqinjë na ka tregu që e ke bërë këtë. "Ky na ka tregu se ti ke ble armë, ky fqinjë na ka tregu që ti kështu". Që të na ndërprejnë edhe marrëdhëniet me fqinjët sepse ata i kanë pasë adresat, nuk ka qenë e vërtetë, fqinjtë nuk i kanë bërë kto gjëra se unë kom qenë e sigurtë prandaj nuk u kam besuar. Por ka mjaftu që në ato rrethana na kanë mbajtur me orë të tëra dhe kjo ka qenë kjo pjesa ma e lodhshme. Sepse ndonjëherë ajo ana fizike nuk dhemb shumë sa ana shpirtërore dhe psikike. Megjithatë edhe këto kanë kaluar.

Unë kam vazhduar aktivitetin tim. E ndodhi 7 marsi, dita e themelimit të Forumit. 8 marsi ishte dita kur ne e morëm mendjen të dalim me ni minut heshtje, t'i nderojmë djemtë e vrrarë në ushtri të cilët silleshin me arkivole. Dhe unë e bëra ni shkrim me dorë shumë shpejtë në zyrë dhe i thirra ato shoqet e mia ma t'afërta dhe i luta, thashë, "Unë do të ngritem në këmbë, do ta kërkoj sallën të mbledhemi të gjitha gratë e organizatës", se mora detyrë nga Forumi i Gruas n'momentin që u themelu, "dhe do ta bëjmë një minut heshtje dhe do t'bisedojmë për më tutje çfarë kërkesa do t'i dërgojmë federatës për t'mos vazhduar krimin ndaj djemve tonë shqiptarë", të cilët vriteshin pa pikë faji edhe kërkesa të tjera.

Por, njëra nga shoqet e mia pranoi, "Mirë, ma shkruaj se nuk e mbaj mend dhe unë do të flas", "Shumë bukur". Unë shkova te drejtori, Bajram Morina, dhe i thashë, "Të lutem drejtor, ma lejo sallën e konferencave që unë t'i mbledhi ni grusht gra", sa ishim se nuk ka pasë shumë gra në organizatë, diku 30-40 veta, "dhe të bisedojmë". Ai më mori n'pyetje më tepër se sa ni polic dhe ma lidhi çështjen me çështjen e minatorëve, ma lidhi me gjëra të ndryshme që me të vërtetë ishte e pakapshme. Dhe unë thashë, "Në rregull, nuk ka problem".

I takova shoqet dhe u thashë, "Shikoni, në ora 11:00 në restaurantin e madh ku ushqeheshin rreth 500-600 veta, ne do të ulemi të gjitha në një pjesë dhe unë do ta hapë për ni minut heshtje takimin, e shoqja ime do ta lexon atë letren me kërkesa dhe ne do të duartrokasim, do ta lëmë ushqimin, do ta marrim ushqimin dhe do ta lëmë me tabak, do ta bojkotojmë mëngjesin. E pastaj do t'shkojmë nëpër zyrrat tona". Por, në momentin kur shkuam ne, salla ishte përplot, kishte edhe plot serbë të cilët sot janë në lista të kriminelëve. Kanë qenë udhëheqësja të asaj kohe, sidomos udhëheqësit e organizatës "Metaliku".

Në momentin kur unë u ngrita në këmbë, të gjitha morëm ushqim e lamë në tavolinë dhe të gjitha u ngritëm. Thashë, "Ju lutem të ngritemi në këmbë për një minut heshtje në nderim të djemve dhe bijve tanë që po kthehen në arkivole edhe lavdi". Ajo shoqja ime nuk e mori letrën ta lexoj, sepse vllau i saj

ishite njëri nga udhëheqësit, sigurisht ia bëri me sy dhe ma la përpara. Atëherë, e lexova vet, punë e madhe! Unë isha e pregatitur për të gjitha sfidat. Vazhdova leximin edhe në atë moment i kam parë diku rreth 10-15 burra shqiptarë të cilët janë solidarizuar me neve. Ndërkaq i kam parë serbët që po e hudhin ushqimin me tabaka nëpër tavolina edhe kanë fillu të shajnë nënat shqiptare, mu e të gjitha shoqet që ishim. Unë mendova që aty përfundoi gjithçka.

Shkova në zyrë, shkua të gjitha. Pastaj ajo shoqja ime qau, tha, “Nuk pata guxim”, nuk ma tregoi realitetin, por e kuptova. Vërtetë ka pasë dëshirë, po nuk ka pasë guxim. Këto dyja nuk shkojnë bashkë gjithmonë. Nuk shkoj shumë kohë, po më thërret centralisti, Cylja Shehu, ni atdhetar i madh që edhe tani jeton edhe më tha, “Zonja Mevlyde, po të thërrasin por unë do të mbaj linjën e hapur dhe do ta dëgjoj gjithë bisedën në telefon. E pastaj unë do t’i lajmëroj qarqet tjera në Lidhjen Demokratike në mënyrë që nëse ndodhë diçka me ty s’paku le ta dijnë pse”.

Mu më mori drejtori dhe krejt këtë bisedë e ka dëgju Cyljaja. Dhe më tha, “Ti ke bërë kështu, u ankuan, Jovica e tjetri e tjetri”, me emra serbë, “Po”, thashë, “çka m’intereson mu? Unë askujt nuk i bëra asgjë. Ne bojkotum ushqimin tonë që paguajmë, shfrytëzuam kohën e pushimit. Ti nuk ma dhe sallën që ta bëjmë këtë takim të izoluar. Ti vet më ofrove mundësinë”. Atëherë më thirri në zyren e tij, m’detyroi të shkoj. Unë u detyrova sepse ishte drejtor i imi dhe natyrisht që u detyrova. Pastaj atje u grindëm aq shumë, më mbajti aq shumë në bisedë dhe nuk la asgjë pa më kualifikuar. Duke më dhënë kualifikime që unë jam kundër shtetit të Jugosllavisë, po rrënoj Jugosllavinë, se Jugosllavia ishte vendosur në tavolinën time.

Thashë, “Zotëri, ti me tënden unë me timen, unë jam kjo. Asgjë më tepër nuk do të ndodhë se të më vrasin, e po tjetër çka?” Thashë, “Jeta ime nuk përfundon ktu, unë i kom fëmijtë në shtëpi dhe jeta ime vazhdon”. Pastaj, më vonoi tepër dhe orari i punës po vazhdon. Të gjitha shoqet e mia i kishte organizuar zonja Hajrie Shedati, e cila jeton edhe tani, ni gru e zoja, ni gru e sinqertë, ni ardhëtare e madhe. I kishte organizuar te autobuset, sepse organizata jonë ishte diku dy kilometra në periferi dhe nuk i kishte lënë gratë të nisen në shtëpi derisa t’dalë unë nga biseda informative te drejtori i organizatës.

Drejtorit i thashë, “Ti nuk ki drejtë pas orarit të punës të më ndalosh, sepse atëherë ti po më diskriminon. Deri në orar të punës mund t’më marrësh n’pyetje, tani mbaron orari”, dhe unë u çova demonstrativisht e përplasa derën dhe dola. Kur dola me të gjitha ato ngarkesat psikike u çlirova për ni moment kur i pashë t’gjitha gratë duke më duartrokitur, duke më përkrahur, duke më përqaftuar dhe shkova n’shtëpi. Kur shkova n’shtëpi i thashë Agimit, “Gjërat po shkojnë ma vështirë, por nuk e kom ndërmend të ndaloj. Nuk e kom ndërmend, unë do të vazhdoj. Pregatituni. E ke pasë fatin ta kesh ni grua e cila prej momentit në moment nuk do t’jetë këtu po do të burgoset”, tha, “Unë do t’përkrahë me gjithë fuqinë time, përkrahja ime do t’jetë deri në fund. Aty nuk mund t’pytem unë se çka do të ndodhë, por mos u shqetëso për familje, vazhdo! Vazhdo rrugën tënde, është rrugë e jona e përbashkët”.

Por, përveç meje, Agimi ka punuar dhjetë fish ma shumë se unë. Jo vetëm përkrahje, por ka qenë një ndër aktivistët më të mdhej edhe në bashkësi lokale edhe në shoqatë humanitare edhe në qytet edhe kudo. E tani çka të them se ditët vinin duke u rënduar edhe më tepër. Drejtori im i famshëm më largoi nga puna. Menjëherë më paraqiti si tepricë teknologjike. Sindikata e pavarur, më ndrroi kryetari i sindikatës edhe unë nuk u ktheva në shtëpi vazhdoja me dhunë të qëndroja në zyrë, pa pagesë, ta udhëheqi sindikatën e të bëhen protesta të ndryshme. Ka ndodhë ni protestë e madhe në Gjakovë ku kanë marrë pjesë 60 mijë veta edhe kom dale në protestë në oborr të Sallës së Sporteve “Shani Nushi”...

Anita Susuri: Në cilin vit? Viti ‘90?

Mevlyde Mezini Saraçi: Viti ‘90, po. Edhe kanë folë që, “Ne nuk jemi lavatriçe, jemi nëna, armiku le të shporret”. Unë e di që ni udhëheqës i Gjakovës edhe ai atdhetar ka qenë drejtor në KBI Ereniku dhe më është afruar afër dhe ma ka kapur brrylin {e kap brrylin} tha, “Të lutëm vetëm emra mos jep, sa t’dush shaj, por emra...” Ai më ndihmoi thjeshtë. Unë nuk i përmenda edhe pse nuk i dija emrat komunistëve në udhëheqje të federatës, por unë të gjithë udhëheqësit... edhe fola aq shumë sa nuk e mendova pastaj çka do të ndodhë. Nuk kaloi shumë kohë erdhi autobllinda për ta shtypë protestën dhe ne vazhduam nëpër qytet nga një pjesë në tjetrën. Ata duke na ndjekur.

Kjo njihet ndër protestat më të mdhaja në Gjakovë, ku janë ngritur të gjithë punëtorët edhe qytetarët e Gjakovës. E pastaj aty diku shtatë-tetë orë i kom kalu nëpër protesta me të gjithë, me të gjithë të tjerët, jo vetëm. Dhe kur kemi shku në pjesën te ura, domethonë ura afër muzeut që të shpie për Çarshinë e Vjetër, aty nuk e dija as vet si kam shpëtuar. E kam k[apër]cyer një mur të urës që tani kur e shoh nuk e besoj. Kom kcy për t’u larguar se aty prangat i pata afër dhe shpëtova. Nga aty pastaj përreth lumit nëpër familje, nëpër shtëpija dhe përfundova te kopshti i fëmive. Sepse kisha për t’shku për t’i marrë fëmijtë në kopsht. Ashtu e kishim orarin me bashkëshortin që unë e kisha kohën e caktuar.

Sapo mbrriva te kopshti u gjujtë ni bombë me gazlotsjellës dhe në moment e hupa orientimin. Ni qytetar kishte ardhë për ta marrë vajzën e tij në të njejtin kopsht. Atëherë, kur e pa ai edhe kishte pa se çka ka ndodhë me shpejtësi m’ka futë në veturën e tij. M’ka thanë, “Futu në veturë në këtë mjegull t’mos shohin kah po shkon”. Kemi shku te kopshtorja. Ai ka hy i ka marrë dy fëmijtë m’ka sjellë deri në shtëpi dhe m’ka thanë, “Mos trego kush t’ka pru”. Kom pshtu edhe atë ditë. Ka qenë edhe ky ni moment, ni fat që kom shpëtuar.

Por të nesërmen sërish protesta tjera në organizatë. Shtatë ditë e kemi ndërpre prodhimin. Sërish aty ni kryetar i sindikatës të ni reparti më ka kualifiku me elemente të ndryshme kinse jam kundër Jugosllavisë. E sot e kësaj dite shtiret si patriot. S’po du as ta përljy gojën ta përmend emrin atij, por le të jeton me turpin e vet. Edhe ai i detyroi edhe sindikalistët të më largojnë edhe nga zyra. Atëherë, unë

mbeta në shtëpi. Por nuk mbeta në shtëpi se unë aktivitetin e vazhdova dhe kisha kohë më tepër për aktivitet në teren.

Në të gjitha fshatrat e Gjakovës i themelëm nëndegët e Forumit të Gruas, takimet javore në Prishtinë në kryesinë qendrore, mora pjesë në kuvendin zgjedhor. U zgjedha anëtare e kryesisë së Forumit të Gruas në nivel Kosove, u bëra anëtare e Komisionit për të Drejtave të Fëmijëve në nivel qendror. Në Gjakovë anëtare e kryesisë së degës. Pastaj u zgjedha kryetare e Këshillit Komunal për Solidaritet. Pastaj me themelimin e “Nënës Terezë” degës në Gjakovë e themelova bashkësinë e parë lokale. Takime, veprime, ndihma, lëvizje, shkresa, deklarata, intervista pandërpre. Por, përkrahjen e familjes e kam pasur gjithkund dhe kështu kam vazhduar gjatë gjithë viteve pa kursy vetën. Pa të ardhura personale, pa marrëdhënie pune, pa asgjë.

Tani ne udhëheqim organet paralele të komunës edhe nivel kombëtar dhe unë kërkova të punësohesha në arsim. Meqë isha e diplomuar dhe atëherë u punësova në Shkollën “Gjergj Fishta”. Kam kaluar shumë vështirësi. Me ni kolektiv të mrekullueshëm, me nxënës të mrekullueshëm, ato vajza të zgjuta si sorkadhe me ata djem të mirë. Gjithçka ka qenë bukur, kolektivi i mirë, por ka qenë vshtirë të udhtohej çdo ditë. Shtatë kilometra është dashur t’i kaloj shtatë posbllloqe. Dhe kam kalu ashtu. Por në oborin e shkollës ka qenë Kooperativa Bujqësore. Zakonisht Serbia kishte instaluar këto segmente me kohë por ne nuk kemi ditë.

Në çdo oborr shkolle në fshatra Kooperativa Bujqësore, Posta, dhe aty gjithmonë ata spiunët serbë, çfarëdo nacionaliteti, po spiunët që kanë spiunu njerëzit e veçantë. Dhe unë kom qenë e përndjekur gjatë gjithë kohës. Ni ditë prej ditës duke zhvilluar mësimin në klasë po troket drejtori i shkollës dhe më tha, “Të lutem arsimtare a ka mundësi të vish në zyrën time? S’paku le të arrestojnë në zyre e të mos arrestojnë para nxënësve, sepse policia në derë po t’kërkon”, thashë, “Jo drejtor, të lutem mbylle derën. Unë jom Zot në klasë gjatë orës të mësimin. Nuk ka të drejtë as me ligje të Serbisë”, aso kohe, “të futet në klasë askush. Fillon ora e msimit profesori e ka obligim me nxënësit të shtjelloj lëndën dhe nuk ke të drejtë”, tha, “Po trishtohen”, thashë, “Le të trishtohen se edhe fëmijtë e mi po trishtohen çdo ditë. Le ta kuptojnë edhe këta realitetin”.

Ai nuk e kishte qëllimin e keq, por unë nuk deshta se gjithmonë kom qenë kokëfortë. Ka qenë vështirë dikush me më i thy vendimet e mia edhe kur nuk m’ka dalë mirë. Po mbi 90 përqind i kom pasë vendimet e drejta. Dhe policia serbe priti derisa mbaroi ora. Sapo dola më morën në pyetje m’dërguan në Koperativë, thanë, “Ose lësho punën me vetëdëshirë ose ne do të arrestojmë”, thashë, “Jo, unë e kom kontratën e punës dhe nuk kam kurrfarë dëshire ta lëshoj punën. Nëse ju m’arrestoni atëherë ju duhet t’jepni arsytimin, unë do të vazhdoj të ankojem”. Edhe sigurisht kaloi edhe kjo punë sepse e shishin edhe ata që unë nuk isha kafshatë e lehtë për ta.

Mirëpo, kjo puna ime ishte me kontratë. Përpara nuk kish mundësi Republika e Kosovës si organe paralele të bënim vendime të përhershme me kontrata. Çka ndodhi? Pak para se të burgosesha, kur

bëra paraqitjen në konkursin për vitin vijues nuk u pranova. Jo me dëshirën e shkollës, por me detyrimin e organeve udhëheqëse që t'mos jem aty sepse unë i frymëzoja. Dua ta përmend edhe ni rast në shkollë. E bëmë ni orë mësimi dhe unë e shkruva, atëherë ishte aktuale Lëvizja Gjithëkombëtare edhe e shkruva në tabelë, "Ibrahim Rugova është kryetar i Republikës së Kosovës". Të gjithë nxënësit e shkruan. E gjetën kryefjalën, kallxuesin, e analizun fjalinë shumë bukur. Nuk ishte qëllimi krejt te fjalja, por qëllimi ishte që fëmijtë të marrin pak frymëzim sepse edhe fëmijtë shumë herë ndikojnë në familje.

Mirëpo, njëra nga vajzat e klasës shtatë e mbylli fletorën e futi lapsin në mes të fletorës e uli kokën edhe filloi të qaj. Edhe unë u afrova thashë, "Shpirti i mësuses pse nuk shkruan? A ke lapsin?" Tha, "Po, e kom", thashë, "Po pse?" Tha, "Unë nuk kam guxim se për çdo ditë vjen Millutin Pansheviçi te babai im". Millutin Pansheviçi ishte kriminel i llojit t'vet. Ai ishte në lagjen time banonte dhe ai ka kryer shumë krime në Gjakovë e rrethinë. Dhe kjo vajza e ka kuptuar se sigurisht e ka dëgjuar se emri im është përmendur në shtëpinë e tyre dhe mënyra ma e lehtë ka qenë, "Po ai m'i kontrollon librat, mandej mësuse ti do t'arrestohesh". Thashë, "Shkruje lirisht dhe kur të vjen Millutini le t'lexon dhe ti tregoj që nuk je fajtorë dhe t'ka detyru mësusja". Nuk e pranoi vajza. Tha, "Jo s'paku nuk du ta ndjej vetën fajtorë" sepse n'klasën e shtatë ishte vajza mjaft e pregatitur për jetë, ishte një vajzë e zgjuar, nxënëse e shkëlqyeshme.

E këtu du ta boj ni paralele, domethonë, prindi ka qenë bashkëpunëtor, por fëmia ka refuzu bashkëpunimin. Pse? Se nuk ka dashtë me qenë ni pjesë e lidhjes së diskriminimit tim apo burgosjes time përmes një fjalie. Dhe unë kuptova që çdo ditë po bëhet më vështirë. Një ditë prej ditësh unë me kokën time mora "Mesharin" në shtëpi dhe ta shpjegoj. U ula në autobus dhe në pjesën diku kilometrin e tretë policia e Serbisë po futen në autobus. Nga t'ia mbaja? Sapo u futa në autobus "Mesharin" e kisha në çantë dhe ç'të bëj tani? Erdhën policia. Momenti i parë ata i futnin duart nëpër çanta. Unë e nxora "Mesharin" e lashë në ulëse dhe dola në ulësen përballë, për fat ishte e zbrazët. Dhe policia nuk u mur me ulësen e zbrazët, "Meshari" aty qëndronte krenar (qeshë). Unë ulur përballë e shikoja msheftas dhe policia ma bëri çantën shportë. Çdo letër që pata në çantë ma hodhi për tokë. Unë i mblodha edhe kur zbrita te shkolla, "Mesharin" e futa n'çantë. U shpjegova fëmive, u tregova.

Pastaj, ni koleg i imi i cili ishte profesor i artit figurativ e luta që ta vendosë në setrën e tij, në xhepin e brendshëm t'ma sjellë deri në shtëpi, se ishte e pamundur që të mos kontrollohesha në të dy rrugët. Ka qenë momente të vështira, udhëtim i vështirë, përvojë e vështirë por ende e rujë kënaqësinë, krenarinë e asaj kohe sa kom punue. Madje, madje, tani me këto rrjete sociale kur marrë komente nga nxënësit e mi të cilët kanë arritë shumë suksese në jetë, kanë përparuar. Ka të tillë që vijnë më vizitojnë edhe në familje, ka të tillë që më shkruajnë, më kanë gjetë mas shumë kohe. Krenohen... me ato komente e tyre. Unë ndjehem mbretëreshë, sepse vërtetë kanë qenë të tillë.

Unë nuk e di në cilën komunë ka pasë shkollë ma të pregatitun se shkolla “Gjergj Fishta”. E kam pasur edhe kolegun tim Gaspër Karaçi, ai është dëshmor i kombit që ka qenë një ndër figurat kryesore në shkollë që ka qenë i disiplinuar...

Anita Susuri: Po, ishit t’u na tregu për nxanësit e juv që janë krenar me juve...

Mevlyde Mezini Saraçi: Po, nxënësit janë shumë krenarë madje edhe e shprehin atë përmes vizitave, komenteve që e bëjnë nëpër rrjete sociale, thirrjeve me telefon, takimet fizike që i bëjnë dhe kjo për mu është ni pjesë e ndritshme e jetës, sepse kom mbri të lë gjurmë në ni kohë shumë të rëndësishme në zhvillimin e tyre, jo vetëm arsimor, por edhe edukativ dhe patriotik. Prandaj, kjo është ni mënyrë në të cilën jo vetëm unë por secili profesor apo profesoreshë duhet të ndjehet krenarë që ka lënë gjurmë për atë kohë. Se vërtetë ka qenë kohë e vështirë edhe unë e kom qenë e re edhe unë kom pasë familje edhe unë kom dashur të flej në mëndafsh po nuk kam mundur. Nëse tjetri nuk ka pasur bukë, si kam mundur të ngopem unë me fëmitë e mi? Jo, unë nuk kam mundur.

Unë i kom marrë rrobat e fëmive dhe ua kam dhuru bashkëmoshatarëve të tyre. Edhe besoni ky moment është shumë i mirë dhe është ni mision shumë human që po bëni ju, sepse ka gjëra që unë nuk i kom përmend në jetë. Kanë ndodhur, kanë kaluar dhe nuk m’u ka dhënë rasti, sepse jeta është aq dinamike sa nuk kanë kohë njerëzit të dëgjojnë. Është ni kohë e vrullshme që secili lufton për ekzistencë. Por, edhe atëherë ka qenë ni luftë, por ka qenë ni solidaritet më i madh. Tanimë si edukatore dhe si veprimtare i kisha dy mundësi, dy dyrë të hapura të bëjë veprimtari. Tanimë i njofta të gjitha vendbanimet e Gjakovës edhe nga brenda. E dija secila familje çfarë nevoja ka. Sepse në Gjakovë Forumi i Gruas ka qenë shumë aktiv edhe në nivel të Kosovës.

Unë niherë n’javë kom lëvizë edhe kom pru shumë materiale, dëshmi, deklarata, fotografi. Por, në Gjakovë kemi lëvizë, kemi ndihmu shumë familje, kemi organizu terrenet edhe më malore. I kemi thirrë gratë të cilat i kanë lanë turrshitë me një anë edhe burrat i kanë ndihmu që të vijnë në takime, sepse secila prej tyre ka dashur t’jepë diçka. Prandaj, Forumi i Gruas është një organizim që duhet të vlerësohet ni histori që kurrë nuk shlyhet e vërteta, që ka dhënë kontribut jo vetëm si grua po kontribut politik, human, patriotik edhe ka bërë ni sakrifice të jashtëzakonshme.

Forum i Gruas ka pasë brenda të gjitha shtresat e grave që nga amviset e deri te doktorët e sheknave, por të gjitha kemi qenë të barabarta, të gjitha kemi dhënë gjithçka nga vetja. Aty s’ka pasë kategorizim, “Jo unë jom profesoreshë dhe s’do shkoj”, po kemi shku në pikat ma t’largëta të gjitha i kemi paguar vet. E tani të them mbeta pa punë dhe si paguva? Po i kom pasë familjarët e mi jashtë të cilët janë përndjekur në vitin ‘94, e disa ‘92 dhe janë detyru të ikin jashtë. Tani ata nuk kanë pasur mundësi drejtpërdrejt të kontribojnë mrena në Kosovë, ata më kanë dërguar mu mjete që të mbijetoj për të qenë krenare edhe për të pasë bukë për familjen edhe mjete sa për udhëtimin tim për aktivitete.

Dhe kjo ka qenë ni pjesë pozitive, ku i falënderoj të gjithë dhe në veçanti motrat e mia Fatmiren edhe Vjollcen të cilat kanë dhënë aq shumë për mua. Të cilat bashkë me familjen e tyre kanë ndarë kafshatën e gojës, sepse nuk ka qenë kohë e lehtë edhe ato si refugjate të ndajnë gjysmën e të ardhurave për të mbijetuar unë vet e shtata. Sepse pesë fëmijë të rritur me obligime, me veshje, me ushqime, me të gjitha këto. Por, ka qenë krenari. Të them për Gjakovën, që Gjakova si komunë ka qenë shumë solidare, por ka qenë pak ma e pregatitur me ushqime. Sepse gjakovarët njihen tradicionalisht si njerëz kursimtar, kursejnë, por jo sa për të mbetur, domethonë mangu për gjëra tjera. Por dijnë të menaxhojnë buxhetin edhe sot e kësaj dite, dallojnë nga komunat tjera. Janë shumë kursimtar, por gjithmonë i kanë të gjitha.

Momenti i parë kur po pregatitem për vizitë në Drenicë, në Drenicë kishte fillu jeta të vështirësohej shumë më herët në vitet e '90-ta dhe ne u organizuam si Forum i Gruas për të mbledhur ndihma dhe kemi dërguar këmisha nate për spitalin e lindjes, për repartin e lindjes në Skenderaj. Kemi marrë materialin, ndihma nga një dyqan, ndërkaq rrobaqepëset i kanë qepë pa pagesë ato. Domethonë, u kanë punë vullnetare. Dhe ne grate kemi shku vetë i kemi vizitu spitalin edhe familjen dhe u kemi dërguar ndihma me autobus, i kemi mbushë gepekun e dy anëve të autobusit me pako të mdhaja ku secila familje ka marrë pjesë.

Madje, madje, kemi organizu ni aktivitet nëpër shkolla ku fëmijët i kanë shky fletët e fletorëve dhe kur nuk kanë pasë mundësi ma shumë dy-tri lugë detergjent i kanë bo fishek edhe ashtu i kanë sjellë me zemër, me dashuri për Drenicën. Apo çanta, rroba të reja gjithmonë të hekurosura, të pastruara. Gjitha këto i kemi dërgu edhe barna të ndryshme në Drenicë për popullatën. Pastaj kemi vizitu familjen e Adem Jasharit pas sulmit të parë e të dytë, kemi qenë në familje. Se Forumi i Gruas në bashkëpunim me Skenderajin, me Forumin e Gruas që e ka udhëheq Hajnishahe Shala-Halimi, tanimë e ndjerë, ni gru shumë e zonja, me Shukrien, Çezibanën e shumë veprimtare tjera që mos t'ju mbes borxh t'i përmend, por janë të nderuara ato që janë gjallë dhe gjithmonë i kujtojmë ato që nuk jetojnë më.

Por, Forumi i Gruas ka qenë ni trup, nuk ka pasur dallim cila komunë jemi. Kur ka qenë puna të lëvizim, ne kemi lëvizë aty ku ka pasur nevojë dhe kemi bërë statistika. Cila komunë ka qenë më e rrezikuar aty shkojmë, cila ka kapacitet të ndihmojë, aty. Po kjo punë nuk osht' bërë vetëm prej grave, sepse na kanë përkrahë edhe burrat. Jo vetëm burrat e familjes po edhe bashkëpunëtorët tone në parti në Lidhjen Demokratike. Kanë qenë shumë koherent, kanë qenë shumë të përgjegjshëm. Në çdo aktivitet tonin na kanë shoqëruar, sepse çdo hap që kemi bërë kemi qenë të përndjekura.

Pjesa e Katërt

Anita Susuri: M'interesoi shumë për familjen Jashari që thatë jeni shku me u taku me ta...

Mevlyde Mezini Saraçi: Po.

Anita Susuri: Si keni kalu atë ditë dhe çfarë familje ka qenë? Qysh jeni ndi me ta?

Mevlyde Mezini Saraçi: Ka qenë ni moment shumë i rëndësishëm. Herën e parë kemi shku edhe nuk jemi futë brenda, ndërkaq herën e dytë kemi dërgu ndihma e pastaj kemi shku edhe ta vizitojmë familjen. Adem Jashari edhe Hamza kanë qenë, domethonë të mobilizuar në aktivitete ushtarake dhe nuk i kemi takuar. E kemi takuar bacën Hamëz dhe zonjen Zahide. Edhe sot e shikoj atë sallonin ku u futëm, sallon i madh i punuar me ato gravurat e traditës. Ne bashkë me... nga Gjakova shkuam Forumi i Gruas, ndërkaq në Drenicë na u bashkuan edhe anëtarët e Kryesisë të Lidhjes Demokratike edhe Forumi i Gruas komplet. Ishim diku 12-13 veta. Na pritën jashtëzakonisht mirë, u erdhi shumë mire.

Baca Shaban tha, “Nga Gjakova keni ardhë? Është e pamundur”, “Po, kemi ardhur të ju vizitojmë, të ju mbështesim”. Atëbotë, ata nuk kishin nevojë për ndihma, kishin nevojë vetëm për përkrahje morale. Aty nuk dërguam ndihma, por vetëm shkuam t’i përkrahim edhe t’i garantojmë se ne jemi në rrugën e drejtë, ne do të punojmë pa marrë parasysh sakrificat. Tani m’duket sikur jam aty, kur baca Shaban i tha, “Çu moj fisnike”, tha, “përgatiti drekë se na kanë ardhë bijat nga Gjakova”, edhe ajo tentoi të ngritet të përgatitë diçka të organizoj me gratë e shtëpisë. Atëherë, ne i thamë se nuk guxojmë të qëndrojmë më tepër sepse nëpër dritë duhet të kthehemi në Gjakovë, “Po na nxuni terri neve do t’na zhdukin”, edhe e lutëm që të mos përgatitë.

Por, si sot m’kujtohet kur njëra nga zonjat të cilat nuk jetojnë më janë dëshmore të kombit e solli ni tabaka plot me gota me lëngje me ujë të ftohtë edhe na gostiti. Bëmë bisedë dhe zoti Shaban tha, “Liria nuk është larg, vetëm mos u dorëzoni”. Tani m’rrijnë para syve ata fëmi, të gjithë u futën në odë sepse për ata ishte ni nderë i madh që shkum na edhe ishin interesant edhe bisedat. Ne i pamë ato vajza të bukura, ata djem, ata sy shkëlqimë. Është ni moment që njeriu e përjeton ni herë, po fatkeqësisht kisha dashtë ta përjetoj, t’i shoh edhe pas luftës (qan).

E përfundum bisedën, i tregum bacës Shaban edhe zonjës Zahide po edhe grave t’cilat na përqafunë shumë, na urun udhëtim të mbarë dhe nga aty shkumë në Uçë. Në Uçë ishin vra punëtortë e arsimit në mbrojtje të shkollës shqipe “Tre dëshmorët e Uçës”, dhe shkuam edhe në Uçë dhe prej Uçës pastaj dolëm në rrugë e pritëm autobusin e Gjakovës. Edhe në Uçë ka qenë ni ditë e jashtëzakonshme, ka pasë diku mijëra vizitorë për atë organizimin e pritjes së mysafirëve për ngushëllime në një fushë. Aty na shërbyen me kafe dhe delegacioni me t’cilin ishim, kishin respekt për mu. Nuk isha me moshë ma e vjetra, por nuk e di as vet gjithmonë m’kanë nderu edhe më thanë të flas diçka në Uçë.

Në momentin kur e pashë gjithë atë fluks të qytetarëve nga mbarë Kosova në ni shtet të okupum siç ishim ne nga Serbia nuk munda të flas, nuk munda, m’u mbyllë, m’u ndalë fjala, m’u mbyllë fyti, nuk pata mundësi edhe gati rashë n’koma. Atëherë ka vrapu ni qytetarë i cili paska qenë ni koleg i burrit tim në Gjakovë, në organizatë, por prejardhjen nga Istogu dhe unë nuk e kom ditë. Ai ka vrapu ma ka sjellë ni gotë ujë dhe ma ka kthi atë vetëdijen, atë momentin dhe unë nuk kom mundur të flas. Veç e di që

kom qajtë aq shumë, sepse për mu ka qenë me randësi ajo vizita, ajo mbështetja morale e njerëzve, se njerëzit po vriten e kolonat nuk po ndalen dhe nuk ka pasë kush e ndalë lirinë.

E si jemi kthi në Gjakovë pastaj? Vetëm ato që kanë qenë me mu dijnë ta shpjegojnë. Nëpër tortura, nëpër malltretime rrugës, duke na ndaluar policia në disa pika. Diku vonë ka ora 10:00 e mbramjës kemi mbërri në Gjakovë. Por, kjo nuk na ka ndalu...

Anita Susuri: Keni pasë autobus të organizum?

Mevlyde Mezini Saraçi: Jo, jo...

Anita Susuri: Vet kështu.

Mevlyde Mezini Saraçi: Nuk kemi guxu atëherë të organizohem, vetëm të përzihemi me qytetarë. Po ka qenë shumë vështirë, sepse ne vetëm kemi qenë persona të identifikuar. Tanimë na njofti bota. Na njofti, po mendoj, bota n'atë mënyrën sa për t'na përndjekë ishim emra eminent edhe shpëtuam, sepse nuk kishim asgjë me veti, barrë. I lamë ndihmat, i përfundum ndihmat edhe në autobus kah shkumë na nuk u morëm me ndihmat, u morë vozitësi edhe ndihmësi i vet sikur nuk janë ato me neve.

Por, Drenica ka pasë ni bashkëpunim të jashtëzakonshëm me Gjakovën, për çfarëdo nevojë na kemi qenë bashkë. Por jo vetëm Drenica, por Lidhja Demokratike ka pasë ni shtrirje të jashtëzakonshme. Ka funksionu edhe si parti edhe si shtet, te dyjat. E tani për vazhdimësinë e Forumit të Gruas, çka t'them përpara, kaq shumë ka punë e aktivitete që me të vërtetë duhet secila prej nesh që kemi qenë pjesëmarrëse nga ajo e para deri te ajo e fundit si anëtarë të tjerë, ka çka shkruan dhe fatkeqësisht që nuk janë shkruar këto gjëra. Sepse kto duhej t'ishin pjesë historike për gjeneratat e reja. Mos të harrojmë të kaluarën e lavdishme të vështirë, por të jenë të përgatitura për t'ardhmen pa u dorëzu.

Por, natyrisht, janë krenar edhe me nënat, gjyshet, tezet, hallat, sepse të gjitha kemi pasë ni lidhje shpirtërore, familjare me dikë. Ishte momenti kur u mbyllë shkolla shqipe. Tre-katër serbë me dhjetra profesorë serbë nëpër klasa, ndërsa fëmijë tonë pa msim. Edi Shukriu, kryetare e Forumit të Gruas na mblodhi në ni takim t'madh në fshatin Landovicë, dhe në Landovicë e kishte inskenu nëndega e Forumit të Gruas të Landovicës në bashkëpunim me kryesinë e Forumit të Gruas të Prizrenit, sikur po martohej ni vajzë që ne t'kemi mundësi të depërtojmë deri aty.

Në hyrje të rrugës për atë fshat, te xhamia na priti postblloku i policisë, "Ku po shkoni?" "Po shkojmë, ka me u martu ni vajzë", edhe kështu shpëtuam. Atë ditë ndodhi ni takim i jashtëzakonshëm, ni mobilizim i grave për të vepruar, sepse shkolla u mbyll edhe tash fëmijë mbetën nëpër shpija, çka t'bëjmë? Morëm vendim që të mbahen dy orë mësim në ditë. Aty morëm detyrat të mobilizohemi ne që ishim të kualifikuara si mësimdhënëse, por edhe koleget tona tjera të cilat ishin përjashtuar nga puna, nga shkolla. Përfundoi ai takim i rëndësishëm, morëm detyrat, u kthym dhe besoni që tanimë

mund të krenohet kushdo që t'jetë nga organizmat shtetnor, por themelimi i institucionit shkollë-shtëpi ka ndodhë prej Forumit të Gruas të Lidhjes Demokratike të Kosovës, vendim i cili është marrë në fshatin Landovicë. Për momentin datën nuk e kom me veti, por e kam të regjistruar.

E tani filluam në shtëpi të ndryshme ku ka hapësira t'i grumbullojmë fëmijtë, aq sa kemi mundësi të lagjës e më vonë mandej vazhdoi organizimi kryesor nivel shteti, shteti paralel dhe ndodhën këto organizime tjera shtëpi-shkolla me segmente shtetore. Vlen ky moment të theksohet se ka qenë përgjegjësi e grave, nuk janë paguar aktivitetet, nuk janë paguar mësimdhënëset, nuk janë paguar shtëpitë të cilat i kanë lëshu. Domethonë, gjithçka ka qenë vullnetare. Përveç që ka qenë sakrificë se shumë mësuse janë burgosë, po mendoj janë marrë në pyetje, në biseda [informative], janë rrafur mirë, janë përndjekë edhe kryefamiljarët, jo vetëm gratë, e kshtu me radhë.

Pastaj ndodhi protesta e madhe me letra të bardha. Ne morëm ni vendim në kryesi qendrore që të gjitha komunat të bëjnë protestë edhe të dalin me letra të bardha. Domethonë, letra e bardhë e paraqet paqen. Ne nuk jemi për luftë, e Serbia vetëm i kishte futë rrënjët dhe kishte fillu luftën në regjione të ndryshme. Atë ditë në të gjitha pjesët e qytetit veprimtarët e kanë ndërmarrë këtë aktivitet dhe unë kam dalë me shoferin e Lidhjes Demokratike, Fatos Efendija, dhe i kom vizitu të gjitha gratë me letra t'bardha, i kom përshëndetë, i kom inkuraju në të gjitha pikat e qytetit dhe atë ditë, ka pasë edhe shtypje të protestët në shumë segmente ka pasë. Por, kemi shpëtu atë ditë. E kemi dhanë mesazhin tonë.

Momenti tjetër ka qenë ni protestë me balona shumë ngjyrësh. E kemi bërë ni protestë t'i dërgojmë nxënësve balona, jemi organizu edhe pse ka qenë shumë vështirë t'i nxerrim në aktivitet fëmijët dhe t'i shpërndajmë balonat n'ajër si mesazh i paqes. Unë këtë përveç që e kam bërë në disa pjesë të lokalitetit të komunës kom shku në shkollën "Mustafa Bakija" ku ende mbahej mësimi. Aty mbahej mësimi edhe i gjimnazit edhe i shkollës fillore. Ishte objekt n'durë të shqiptarëve dhe kom biseduar me ni arsimtare të klasve të ulta dhe e luta, thashë, "E di që është e vështirë për ty dhe për mua, por ky mesazh le të shkon. Tre mijë nxënës i ka shkolla dhe nëse ky mesazh del nga dritaret e katit të dytë dhe fluturojnë balonat naltë, atëherë është aktiviteti i përfunduar".

Po ashtu edhe në shkollën "Zekiria Rexha", por e kemi bërë në ni oborr mrapa ku ka qenë ni pjesë, ni objekt përcjellës i shkollës. Ndërsa në të gjithë qytetin, jo vetëm në Gjakovë, në të gjithë Kosovën por unë me kompetencë flas për Gjakovën, kanë fluturu balonat shumë ngjyrësh nga duart e fëmive si mesazh i paqes. Edhe ky ka qenë aktivitet i jashtëzakonshëm. Pastaj, u bë organizimi... kur u blloku Drenica, Drenica mbeti në krizë, i numëronin rezervat e fundit. Atëherë, Forumi i Gruas, kryesia e Forumit të Gruas në organizim edhe me organizata tjera të grave që fillunë funksionimin atëbotë, [organizuan protestën] "Ni bukë për Drenicë".

Delegacioni i Forumit të Gruas nga Gjakova u shtyp që në nisje në Gjakovë dhe nuk na u leju të vazhdojmë për Prishtinë. Ndërkaq ky aktivitet ndodhi edhe ka qenë një ndër aktivitetet që ka pasë

jehonë jashtëzakonisht të madhe në shtypin botëror, mediat botërore. Sepse, gratë ishin vendosur që të mbrijnë në këmbë në Drenicë. Edhe ky është aktivitet historik, i guximshëm...

Anita Susuri: E ju në Gjakovë jeni organizu? Jeni nisë?

Mevlyde Mezin Saraçi: Na u nisëm sepse ishte ni pikë qendrore, të takohemi në Prishtinë edhe të nisemi për Drenicë. E tani nisja jonë duhej të bëhej nga Prishtina. Na u nisëm, neve na ndaluan në Gjakovë në hyrje. Ishim të organizuara me ni makinë edhe sapo na ndaloj policia, ata i dinin lëvizjet tona dhe kishin marrë ni informatë që do të ndodhë nisja me bukë. Por, nuk kanë mundur t'na ndalojnë kur kemi bërë aktivitetet para ambasadës, Zyrës Amerikane atëherë. Kur kemi qenë te Zyra Amerikane, aktivitete tjera. Domethonë, çdo aktivitet që kemi bërë jashtë Gjakovës në mënyrë të organizuar janë munduar të na shtypin. Por që fatkeqësisht në Drenicë na nuk kemi mbri të jem askush nga Gjakova, sepse na ndaluan që në fillim.

Pastaj kemi pasë aktivitete edhe për Spitalin e Gjakovës. Jemi aktivizu sepse në të gjitha klinikat e lindjes i vendosën mjektë serbë dhe u ndaluan lindjet e shqiptarëve. Lufta atëherë ishte për t'i penguar lindjet edhe natalitetin, natyrisht ky ishte diskriminimi kryesor. Gjenocid thjeshtë. Në Spitalin e Gjakovës kishte mjekë shqiptarë, drejtori ende ishte shqiptar dhe ishin mobilizu t'i presin gratë lehona nga mbarë Kosova. Gjakova ka qenë pikë e pritjes, Forumi i Grusë kryesisht, të gjithë por them Forumi i Grusë me përgjegjësi ma t'madhe. Por, edhe shtëpia ime ka qenë cak i pritjes së grave lehona. Pasiqë i kanë kry lindjen i kam sjellë në shtëpi derisa kanë ardhë anëtarë tjerë t'i marrin.

Domethonë, shtëpinë time e kam shfrytëzu për të gjitha aktivitetet, sepse nuk kam pasë mundësi t'i them dikujt tjetër, "Hajt po bojmë ndonjë aktivitet në shtëpinë tënde se në timën nuk bën". Gjithçka kom fillu në shtëpinë time. Janë mobilizu vajzat e mija, saqë shpesh e bisedojmë me vajzën e madhe, Rrezartën, e cila ishte n'atë kohë studente, "Mamë edhe ni fëmi në shpi tonë erdhi", edhe ai fëmi tani është gjallë, njëri prej tyre, vjen me familje dhe më viziton. Dhe ajo përkujdesej për fëmijën, për lehonën, sepse unë vazhdoja me aktivitet. Ndërkaq, librin nën krah e mbante. Gjatë përkujdesjes lexonte diçka edhe kishte provimet në studime, në fakultet dhe ndihmonte edhe familjen. Edhe ajo është përkujdesur shumë për fëmitë, Rrezarta. Të gjithë janë përkujdesë, por ajo ka qenë ma e madhja edhe e ka bajtë barrën.

Pastaj, ka pasë shumë gra të dëbuara nga zonat e luftës në Gjakovë. Forumi i Grusë e ka pasë për obligim, në projekt edhe në projekt edhe në vepër t'i identifikoj të gjitha gratë shtatëzëna që kanë për të lindur dhe me ndihmën e "Nënës Terezë", shoqatës "Nëna Terezë" u kemi pregatitur të gjitha pajisjet e para për të porsalindurin. Nga institucionet e Kosovës i kemi marrë nga 300 marka dhe ua kemi dërguar secilës grua për të përballuar ato mometet e para të lindjes. Sepse atë vit kanë ndodhë shumë lindje në Gjakovë, sepse janë dëbuar shumë familje, mijëra familje edhe në atë moment ka pasë natyrisht gra që kanë qenë para lindjes. Edhe kjo ka qenë ni pikë e rëndësishme e aktivitetit.

Por ka qenë ni përndjekje e jashtëzakonshme, sepse ato kanë qenë t'vëndosura në një pako të cilat i ka identifikuar Serbia për LCC [*Low cost carrier*] dhe sapo na shikonin me pako në duar, ne gjithmonë kishim makina, me bicikleta apo këmbë nëpër terrene të ndryshme, na pengonin, na rrëmbenim. Ne përsëri vazhdonim. Këto kanë qenë momente që gratë nuk kanë mendu për vete, asni gru nuk ka mendu. Asni gru e Forumit të Gruas nuk ka mendu për jetën e vet, gjithmonë ka mendu për të tjerët edhe secila prej veprimtarëve ka vepra të jashtëzakonshme. E tani, a po na njohin meritat? Nuk po i njohin, por nuk ka rëndësi. Ne kemi punuar me kohën, me nevojat e kohës, për t'u përballë me realitetin, sepse atëherë nuk kemi menduar që shpëtojmë e lëre më për ndonjë mirënjohje.

Anita Susuri: Ma herët ishit t'u folë për pjesën që ishit para se me u burgosë, viti '98-të kishim vazhdu me atë nëse nuk keni me shtu edhe diçka për aktivitetin?

Mevlyde Mezi Saraçi: Po ka shumë aktivitete të Forumit të Gruas të cilat jom munduar me aq sa kom në kujtesë ta shkruaj edhe një libër të cilin e kam shkruar në vitin 2013 me titull, "Kur jeta duhej jetuar", aty i kom përfshi aktivitetet e mia, por gjithmonë me njerëzit e tjerë sepse asniherë nuk kom punu vetëm. Por shumë vështirë se janë 22 vite, në fakt 32 vite nga fillimi e 22 vite nga përfundimi i luftës. Ka aq shumë aktivitete, sa unë mendoj se duhet t'i bëhet thirrje të gjitha grave që janë të gjalla dhe kanë vepru të shkrujnë secila nga kandi i tyre që ta formojmë një histori të Forumit të Gruas, të një epoke shumë të rëndësishme.

Tani dua të kthehem te aktivitetet grua në Lidhjen Demokratike, sepse unë kom pasë detyra të dyfishta tani. Nga Forumi kom marrë pjesë edhe në kryesinë e Lidhjes Demokratike, aty jom pajisë me detyra tjera. Tani detyra jo vetëm për gjininë grua, por për të gjithë banorët. Dhe unë aty jam zgjedhur kryetare e Këshillit të Komunal për Solidaritet. Ka qenë ni përgjegjësi e jashtëzakonshme sepse kemi shpërnda ndihma nëpër komuna, kemi shpërnda ndihma për minatorët e "Trepçës", e kam ngarkuar thesin 50 kilogram në krah. Nuk e kom ndi peshën. Bashkë me familjen, me familjarët e mi, me veprimtarë të ndryshëm kemi dërgu ndihma në Suharekë, kemi dërgu në anë të ndryshme kudo ku ka pasë nevojë. Domethonë, kemi bo... përveç dërgimit edhe evidentimin e familjeve të cilat janë në nevojë. Kemi bo aktivitete, "Familja ndihmon familjen", e shumë të tjera.

Tani po flas për vitin '98-të kur plasi lufta në Likoshan, u bo ni luftë e rreptë, ni përballje, ku u vranë dhetë veta në familjen Ahmetaj. Atëherë, si Forum i Gruas u organizuam menjëherë dhe morëm pjesë në ngushëllime. Por, përveç ngushëllimeve ne dërguam për momentin disa veshëmbathje, sepse atyre përveç që ua vranë meshkujt edhe mysafirët, ua dogjën edhe shtëpinë dhe ata kishin mbetur pa asgjë. Ne u mobilizuam dhe dërguam aq sa kishim mundësi dhe kapacitet Forumi i Gruas. Pas vizitës, pasoi varrimi në Likoshan, unë atëherë isha si kryetare e Këshillit Komunal për Solidaritet. Tani, pasonte edhe ni detyrë tjetër. U mblodhën të gjitha partitë politike dhe i bënë pesë mijë marka. Pesë mijë marka për t'i dërguar në ndihmë familjarëve të cilët pësuan 24 viktima. Ku t'i vendosë ato para? Dhe i vendosa në trup.

U nisëm në Likoshan, e vetmja grua të gjitha ishin burra, me dy makina. Sapo arritëm te kryqi i Klinës, policia Serbe na ndaloi, i ndalonte të gjithë, “dhe nuk do të shkoni në Likoshan”. Tani njerëzit, veprimtarët që ishin me mua thanë, “Ti kthehu, ne vazhdojmë në këmbë”, thashë, “Jo. Pse çka keni ju më tepër se unë? Unë e kom ni mision që duhet ta përfundoj atje”. Dhe ne u afruam te ni shtëpi më e afërt, e lutëm, e vendosëm makinën në oborrin e asaj shtëpie dhe makina tjetër në shtëpi tjetër dhe u futëm nëpër ara, livadhe, dhe i kaluam pesë fshatra në këmbë. Arritëm nga kthesa e Klinës në Likoshan për t’ marrë pjesë në varrim edhe mbrijmë me kohë.

Jam shumë krenare që mrriva me kry misionin, jo vetëm për të qenë pjesë. Ishte shumë e rëndësishme për ta shtu edhe ni person në numër ku kishte mjaft nga të gjitha anët e Kosovës, po për ta kry misionin, për t’i dorëzuar ndihmat të cilat i kishte dediku Gjakova. Unë arrita aty ta marrë nënshkrimin edhe të kryetarit të degës, Rrecaj, i cili ende është në listën e të zhdukurve por edhe zotit Rifat që udhëheqte Komisionin për Solidaritet të Skenderaj, që atë dokument e kom edhe sot e kësaj dite e ruaj. Ua dorëzova, mora pjesë. Kthimi ka qenë i tmerrshëm pas varrimit.

Pas varrimit jemi ndalu diku te kthesa që ndahet te ura e Drinit dhe aty na kanë nalë dy makinat, sepse ne kur erdhëm te kryqi i Klinës e morëm makinat dhe po vazhdojmë për Gjakovë. Ishte diku ora 23:00 e natës, ecëm në këmbë përsëri fshatrave për t’u kthyer. Kur mbrrimë aty policia na ndaloi edhe të njejtë ishin që na penguan të shkojmë dhe e dinin ku ishim. Na bastisën edhe trupin edhe çantën time, unë e dija që e kom në çantë një letër të thjeshtë të shkëputur prej formatit A4 ku e kisha vendosë nënshkrimin, dedikimin e mjeteve dhe unë e dija se aty do të më pushkatonin. Por, për fat të gjitha gjërat m’i hudhën në tokë, letra nuk shihej askund.

Na dorëzuan, na mpshtetën për makine me automatik në qafë. Në makinën e parë ishin djemtë e Forumit Rinor, ata i rrëmbyen i dërguan në polici i kanë mbajhtë 24 orë. Ndërkaq, neve na mbajhtën disa orë të rrëmbyer, të bllokuar në rrugë, nuk na linin. Na merrnin në pyetje. Neve na rrahën, na malltretuan aq shumë sa na lane në rrugë edhe nuk na linin të endenim, “Do të vdisni ktu”. Atëherë njëri nga kolegët veprimtarë tha, “A ke Zot? A ke familje? Çka kërkon ti me neve tani? Ne jemi mashkuj, pse çka keni ju ma tepër? Kom Zot, kom familje, kom komb”, “Po tani do t’na vrasin”, “Le t’na vrasin, s’paku e kom ni privilegj të jem heroinë e kombit”. Ishte ni frymëzim për mu, sepse unë e dija që nuk do të bëhem heroine. Serbia nuk e ka qëllimin të më bëjë heroinë, ajo e kishte qëllimin t’na bënte viktima apo bashkëpunëtorë.

Aty na mbajhtën gjatë dhe dikur e morën sigurisht atë detyrën [urdhërin] e tyre të na lirojnë, të rrahur, të malltretuar edhe na dhanë vetëm dymbëdhjetë minuta të mbrijmë në Gjakovë, që ishte e pamundur. Po sa u afrum në hyrje të Gjakovës te bodrumi i verës na pritën ni ekspeditë tjetër e policisë. Ai moment ka qenë i tmerrshëm, nuk e di si kemi shpëtuar gjallë. Të gjithëve na rrahën...

Anita Susuri: Prapë?

Mevlyde Mezini Saraçi: Prapë edhe na mbajtën, gjuanin me automatik n'ajër. Edhe ne nuk e dinim predhat a do të hidheshin mbi ne apo do të hidhnin edhe mbi ne, mbi trupat tanë. Na frikësuan, na tmerruan. Tani nuk mund të them se isha aq shumë trimëreshë. Unë kisha qëndresë, por frika ishte prezente natyrisht se njeriu në momente të vështira mendon. Nuk ishte puna, a jeton apo vdes? Por, ishte puna që aktiviteti po zbehej. Sepse të vritesh si një udhëheqëse, atëherë zbehej aktiviteti për të tjerët, nuk kishin motiv sepse askush nuk e donte vdekjen. Edhe aty na mbajtën nga dy orë, pas dy orësh erdhi në mesazh nga policia të cilin e dëgjua përmes mekanizmave të tyre të informimit që, “Lironi këtë grup sepse po e mbajmë këtë tjetrin tani. Dhe ky grupi tjetër do t'jetë peng derisa ta ndërrojmë grupin ta marrim këtë”.

Por, ajo nuk ndodhi. Ne u lirum. Të nesërmen e kishin liruar edhe grupin tjetër, por gjithsesi të përgjuar në aktivitetet tona. Tash kur u ktheva në shpi ishte diku 2:00 e natës, sepse na vonuan. Unë mendoja se do t'i gjej të gjithë në gjumë. E kisha çelsin e shpisë në çantë dhe nuk e kisha më, sepse kur e kishin hudhë çantën me të gjitha gjërat, çelsi kishte fluturuar diku. Po për fat të mirë dera e shtëpisë kishte qenë e hapur dhe unë po futem ngadale mos t'ua prishë qetësinë familjarëve. Kur po hy në sallën, bashkëshorti Agimi dhe vajza Rrezarta po më prisnin. Dhe unë asgjë nuk fola sepse nuk kishim motiv t'i themi fëmijëve se m'rrahën, malltretuan, t'i tmerrojmë.

I thashë Agimit, “Mirë është puna. Jom shumë e qetë vetëm më duhet në tabletë për dhimbje, sepse jam lodhur, në këmbë kom ecë”. Dhimtë e trupit nga rrahjet. Tani po m'pytë Agimi, “A don çaj a kafe?” Dhe nuk ia harroj atë moment. Është edhe kjo në përkrahje. Nuk ishte momenti as për çaj, as për kafe, sepse pas gjithë atij tmerri në Likoshan edhe gjithë atij udhëtimi për mu nuk ishte me rëndësi ta shuj etjen me çaj apo kafe, por për mu ishte me rëndësi që ta marrë përkrahjen e madhe prej fëmijëve edhe prej Agimit. Edhe e luta Rrezartën që edhe ajo të shkon të bjerë në gjumë, të jetë e qetë se unë jom mirë, nuk kom pasë probleme. Atëherë me Agimin sikur me sy ma shumë komunikim se gjendja nuk është e mirë edhe pritet gjithçka. Mirëpo, asniherë Agimi nuk m'ka thanë të zbrapsem. Edhe pse po t'më kishte thënë unë nuk kisha ndaluar. Por, mund ta falënderoj se m'ka përkrahur. Të nesërmen vazhdova me rutinën e aktiviteteve tjera, shumë shpejt ndodhi edhe sulmi në Prekaz.

Pjesa e Pestë

Mevlyde Mezini Saraçi: Ditën kur ndodhi sulmi në Prekaz, unë po kthehesha nga një aktivitet në Prishtinë të cilin e kishim bërë një ditë më parë. Dhe unë atë natë bëra gjumin bashkë me një anëtare të Forumit të Gruas, në fakt nënkryetare, Ganimete Shala, tek motra ime në Breg të Diellit për shkak se s'kishte transport në orët e vona. Në mëngjes në kthesën, po në të njëjtën kthesë sepse ka qenë barikadë, kthesën që të dërgon për Klinë, për Pejë, Gjakovë është një kthesë që i lidh tri qytete, na ndaloj policia serbe.

Nuk dinim që ka ndodhë diçka në Prekaz ende, nuk kishim informatë. Ata u futën me dorëza të zeza na bastisën, na nxorën jashtë autobusit, e rrahën vozitësin me kondak automatiku. Mirëpo, nuk gjetën asgjë sepse ne kishim qenë në aktivitet edhe nuk kishim dokumente me veti. Mezi na liruan të shkojmë në Gjakovë. Kur mrrijmë në Gjakovë, po e shoh bashkëshortin, fëmijtë të trishtuar. Thotë, “A dëgjutë? Ndodhi sulmi në Prekaz”, thashë, “Jo, për Prekaz nuk dëgjum. Por, te na ndodhi ni sulm tjetër në autobus dhe na pengun udhëtimin, domethonë na vonunë”.

Atëherë, menjëherë kom shku në objektin e Lidhjes Demokratike jemi mobilizu me gra, me njerëz. E kom parë ni mobilizim të përgjithshëm, por filloi ni panikë. Fillunë të mbyllen lokalet, se policia serbe ashtu i mbyllte për të i përndjekur, domethonë pronaret e dyqaneve. Filloi të shitet ushqimi me shumicë, ata që kishin para. Por, ata që nuk kishin kishin dalë si të hamendur nëpër rrugë. Atëherë na patëm për detyrë të gjitha aktivistet me dalë në terrenin e vet edhe për t'i qetësuar se, “Krizë nuk ka, Gjakova ka rezerva, jemi të organizuar”. Edhe menjëherë mas sulmit jemi organizuar në Gjakovë të gjitha partitë politike edhe shoqata humanitare dhe e kemi themelua Këshillin Komunal për Ndihma Emergjente me iniciativën e Këshillit Republikan për Këshilla Emergjente.

Tanimë për mua nuk ishte risi, sepse isha kryetare e Këshillit Komunal për Solidaritet dhe vetëm e mora edhe ni detyrë shtesë. Por, kjo e dyta ishte pak më delikate sepse kishte për detyrë ta ndihmojmë Ushtrinë Çlirimtare dhe ta ndihmojmë strehimin e banorëve të dëbuar. Sepse kur filloi lufta në Prekaz, Regjioni i Gjakovës ishte në luftë, ishin shpërndarë, ishin përndjekur që nga Kosharja e të gjitha fshatrat ma tutje i kishin dëbuar dhe i kishin strehuar në Gjakovë. Tani filluan detyrat edhe ma të mdhaja, obligimet ma të mdhaja dhe derisa u bë dërgimi i kufomave të familjeve, u bë grumbull dhe vendosën që ushtria serbe t'i varros me një gropë masive, t'i hupë gjurmët.

Në Prishtinë po punonin pa ndërpre. Atëbotë, Doktor Ibrahim Rugova, president i LDK-së dhe i Republikës së Kosovës në bashkëpunim me Fehmi Aganin, me Rexhep Gjergjin kishin ndërmarrë ni aksion që na kërkojnë nga Gjakova t'i sigurojmë arkivolet, se Gjakova edhe ma herët e kishte traditë i bënte varrimet me arkivole. Kishte më shumë zejtarë të cilët i punonin arkivolet, po kishte edhe Ndërmarrja Komunale Çabrat. Detyra e parë, thirrja e parë ishte drejtuar meje. Isha si kryetare, veprimtare. Në bisedën që pata me profesor Aganin, profesor Agani tha, “Ne kemi biseduar me Kryqin e Kuq Ndërkombëtar. Kryqi i Kuq Ndërkombëtar e ka për obligim t'ju përcjellë juve deri në momentin e dorëzimit arkivoleve dhe kthimin”, “Në rregull”. Tanimë nuk kishim kohë të mendojmë. Qëllimi ishte që të mos humben gjurmët. Nuk kishte kohë për dhimbje apo vajtime ishte koha për mobilizim.

Tani njëri nga veprimtarët, Hajdar Aga, kishte vllaun e tij vozitës me një kamion të madh dhe kishte thirrë vllaun e tij, Qemail Hajdar Aga, i cili nuk jeton më dhe i thotë se, “Ti duhet të shkosh në Drenicë për t'i bartë arkivolet”. Normalisht që ai ka pranë, sepse ishte mision fisnik. Për sigurimin e arkivoleve nuk i kam bërë vetëm unë, por i ka bërë kryesia e Lidhjes Demokratike të gjithë në bashkëpunim me kryetar të nëndegëve, me parti tjera politike. Diku me dëshirë e diku me dhunë, sepse kishin frikë edhe

t'i jepnin arkivolet. Policia u qëndronte afër atyre që i punonin, zejtarëve. Por ne i realizum ta përmbushim numrin e duhur për arkivole dhe të nisemi për Drenicë.

Para se të nisemi në Gjakovë, në oborrin e Ndërmarrjes Komunale Çabratit arriti në makinë nga Lidhja Demokratike e Kosovës. Në atë makinë ishte Profesor Doktor Edi Shukriu, kryetare e Forumit të Gruas, ishte Profesor Doktor Fatmir Sejdiu, i cili atëherë në cilësinë e sekretarit të LDK-së, ishte Ramë Buja anëtar i kryesisë të LDK-së dhe ishte vozitësi Imer Reçica. Domethonë, të gjithë në makinën e Lidhjes Demokratike të Kosovës. Me ta erdhi edhe në makinë e Kryqit të Kuq Ndërkombëtar, me në përfaqësues të Kryqit të Kuq edhe ishte përkthyesi nga Prizreni i cili punonte atë kohë me Kryqin e Kuq Ndërkombëtar.

I vendosëm arkivolet në kamion edhe vendosëm të nisemi në përcjellje të makinës së Kryqit të Kuq Ndërkombëtar, e cila kishte bo në marrëveshje humanitare në bazë të konventave ndërkombëtare edhe me makinën e Lidhjes Demokratike. Ndërkaq, në kamion isha e ulur unë edhe Qemail Hajdar Aga. Dy persona që po shiheshin për herë të parë. Nuk e kisha parë më parë se ai kishte qenë në sipërmarrës dhe është marrë me detyra tjera, mirëpo vllau i tij ka qenë veprimtar i dalluar. E luta Qemailin i thashë, “Unë e ndezë cigaren dhe tani po shkojmë në rrugë të vështirë, e kisha ndezë në cigare”, tha, “Po ti ndeze hape dritaren”, tha, “por unë jam me probleme kardiake”, po thashë, “Vetëm po e dhezi”, ta tërheq tymin e cigarës dy here, sikur m'bënte shoqëri dhe e hodha cigaren jashtë. Dhe më nuk kemi folë asni fjalë sepse edhe nuk njiheshim, por edhe nuk ish vend për fjalë.

Kaluam në pjesë të rrugës dhe kur erdhëm në Komoran ka qenë postblloku më i tmerrshëm në rrugën Gjakovë-Prishtinë. Barrikatat e policisë, ato gurë me thasë, me rrjete, me tankse, me paramilitarë, me policë. Tmerr! E ndaluan makinën e LDK-së edhe të Kryqit të Kuq Ndërkombëtar, natyrisht edhe neve. Kryqi i Kuq i ka treguar se ne po shkojmë me kry në aksion humanitar, kemi marrë lejen prej eprorëve të ish-Jugosllavisë e kështu me radhë. Mirëpo, policia e Serbisë u thotë se, “Deri këtu punon shteti i Serbisë dhe komandon. Prej këtij momenti futeni në lakoren e majtë dhe shkoni në Drenicë, atëherë aty funksionon ajo organizata e paramilitarëve, forcave para ushtarake. Nuk ka komandë. Ushtria, policia serbe ma nuk udhëheq në atë pjesë. Prandaj, ju merrni vendim”.

Përfaqësuesi i Kryqit të Kuq Ndërkombëtar zbriti nga makina, na luti të zbresim edhe na, policia nuk lejoi. U afëru te dritarja, domethonë e kamionit edhe tha, “Unë nuk kom ardhë me vdekë në Kosovë, unë kom ardhë me kry punë edhe kom shumë punë tjera. Deri këtu erdha, nuk ka siguri ma tutje. Unë po tërhiqem, ju merrni vendim”. Unë i thashë... Profesor Doktor Fatmir Sejdiu tha dhe Edi Shukriu, “Çka po bojmë?” “Po shkojmë”. Edhe ata ishin të vendosur, “Po shkojmë”. Makinën e LDK-së e ndaluan të kthehet mrapa. Neve na pytën, “Do të vazhdoni?” Thashë, “Po do të vazhdojmë”, nuk kishte rrugë tjetër na ishim nisë me kry misionin. Dhe tani, kamioni ynë po niset vetëm...

Anita Susuri: Vetëm ju edhe...

Mevlyde Mezini Saraçi: Unë edhe Qemaili, po. Po vazhdon makina rrugën, ndërkaq makina e LDK-së është kthi mrapa sepse e ka gjetë shtegun, sepse nëpër Kosovë ka pasë edhe shtigje që i kanë përgatitë si rrugë dytësore, tretësore. Dhe na bashkangjitet diku në kilometrin e tetë apo nëntë, masi u ndamë, nëpërmes fshatrave dhe janë bashku prapë me neve. Bashkë shkojmë deri te vendi ku ishin vendosë kufomat, te ajo streha e miqve të familjes Jashari ku na priti te dera Profesor Zekirja Cana dhe na puti në ballë mu edhe vozitësin Hajdar Aga. Tha, “Paqi faqen e bardhë”, sikur u çliru shpirtnisht.

U takum të gjithë bashkë. Pak njerëz ka pasë atë moment, sepse lëviznin edhe policia serbe në momentin e arritjes aty tha, “Vetëm 15 minuta keni kohë të ktheheni mrapa. Shkarkoni shpejt arkivolet”. U mobilizun të gjithë e bënë shkarkimin e arkivoleve. Profesor Zekirja Cana po më thotë mua edhe Edit, “Po bëjmë homazhe”. Pjesa ma e madhe e vështirë e misionit tim ka qenë homazhet. Sepse të gjithë ata njerëz i kisha pa që e ceka ma herët në viziten e familjes Jashari. Ata fëmi i kisha pa, qysh na pritën, fëmi të gjallë, vajza të bukura, djem të bukur me ato flokë kaqurrela, me ata sy të bukur sikur ishin të gjallë. Dhe për mua ishte tmerr të kaloj unë para atyne fëmive të cilët ranë për lirinë e Kosovës e t’u bëjë homazhe. Nuk gjeja ngushëllim as fjalë.

Vazhduam deri në fund u bëmë homazhe dhe u ktheva te komandanti legjendar Adem Jashari. Për herë t’parë u takum unë e ai, për herë t’parë e takova edhe Hamëz Jasharin, sepse bacën Shaban veç e kisha pa të gjallë. Adem Jashari gjigand, madhështor, si i gjallë. I pa dëmtuar në figurë sepse ka pasë shumë fjalë e gojëdhëna jo kështu, jo ashtu ia kanë dëmtuar. Ka qenë figura e tij sikur i gjallë dhe ka pasë ni plumb ktu {bën me dorë te fyti}. Për më tutje, në trup nuk e kemi zbuluar sepse ne u kemi parë vetëm fytyrat. Por më mbeten para syve ata fëmi të pafajshëm, ishin vra dhe kishin mbetur të buzëqeshur. Ajo buzëqeshja e tyre, shpresoja se ata do të zgjohen, sikur kishin rënë në gjumë.

Ato vajza me ato elementet që i vendosnin në kokë, vajzat e vogla për t’i rregulluar flokët, me zemra, me dredhza, me qershiza. I kishin mbetë floktë ashtu gërshta. Por, pashë edhe kufoma të djegura. Dy thasë kishin qenë me pjesë të trupit të djegur, kufoma t’pa identifikuar të cilat nuk e di edhe sot e kësaj dite a janë kry, sigurisht janë kry ekzaminimet. Por, ka qenë ni... është shpërnda ni aromë e djegies trupave të njeriut që ishte shumë e tmerrshme, e dhimbshme, pikëlluese, nuk ka fjalë për ta përshkru. Tani u hapën veprimtari se cilin drejtim... nuk kishim kohë, 15 minuta, duhej të kthehemi me kamion. Edi Shukriu më luti, “Eja me ne në Prishtinë. Eja sepse mund...” “Unë e kom kry misionin, duhet të kthehem në Gjakovë, kom punë tjera”. Ajo kishte frikë se tani me kamion ishte më rrezik. Po e kisha obligim, sepse isha peng i detyrës teme. M’u më duhej ta kryja deri në fund aksionin.

U ktheva me zotin Qemail Hajdar Aga pa asni fjalë. S’kishim fjalë as ai as unë. Pamë tmerr edhe nuk e di tmerr ma të madh a ka. Unë ju përgjegjja kryetares të Forumit të Gruas, Edi Shukriut që duhet të kthehem natyrisht dhe u ktheva. Tani rruga e kthimit ishte e pasigurtë, sepse kriminelët serbë edhe pas misionëve që i përmbushnin atëherë ata hakmirreshin në neve. U kthyem dhe diku te ajo kthesa e Dollcit që shkon për Gjakovë, domethonë, kishim diku edhe 25 kilometra për të arritë në Gjakovë na ndaloj policia serbe. Na nxorri jashtë kamionit e mori në pyetje vozitësin, na rrahën me kondak të

automatiku të dyve. Kërkuan llogari prej neve, “Ku keni qenë?” Unë e kisha për detyrë të tregoj të vërtetën, sepse Doktor Fehmi Agani, akademik Fehmi Agani tha, “Ne kemi marrë leje përmes Kryqit të Kuq Ndërkombëtar edhe ky mision dihet botërisht. Ka marrë përmasa ndërkombëtare dhe jemi të sigurtë”. Unë thashë, “Ju e dini ku kemi qenë, ju e dini. Kemi pasë lejen edhe...”

Atëherë, ata përveç që nuk kanë mundur të na pengojnë të shkojmë atje u hakmorrën në neve dyve se neve na zunë viktimë. Na rrahën aq shumë sa që vozitësi e kish të vështirë të vazhdojë vozitjen me kamion. Prapë u kthymë pa fjalë. Dhe unë me kamion shkova deri te zyret e Lidhjes Demokratike që të raportoj që e kam kry misionin. Por, fatkeqësisht i gjeta dyrtë e mbyllura sepse shumë vonë. Atëherë, ata janë detyru t'i mbyllin sepse natën ka qenë ajo lagje e pasigurtë. Por, përmes mekanizmave tonë fizik edhe me telefonatë i lajmërova dhe shkoi lajmi. E tani u bo ni padrejtësi sepse lajmi që ka dalë se Gjakova i dërgoi, Gjakova nuk mund t'i dërgon. Gjakova është qytet që përbëhet prej banorëve, ndërtesave, prej pjesëve tjera por ka individë që i dërgojnë. Sepse nuk është mire të fshehet një e vërtetë.

Unë isha person publik, isha veprimtare, isha kryetare e Forumit të Gruas, anëtare e kryesisë e Forumit të Gruas të Kosovës, i kisha gjithë ato detyra edhe më isha mësu të mirrem në pyetje. Dhe më e kisha harru edhe frikën, jo që isha trimëreshë por s'kisha kohë për t'u friku. Me dy-tri fjalë, “Gjakova i dërgoj arkivolet”, nuk ka rëndësi Gjakova i ka dërgu. Por, Mevlyde Saraçi edhe Qemail Hajdar Aga dhe sigurisht edhe juve ju ka ra, por ka edhe të tjerët që përditë dëgjojnë gënjeshtër. Mu më vjen keq prej familjes Jashari, më vjen keq prej familjarëve të tyre të vvarë edhe të gjallë tani që mu më duhet ta përmend. Por, e vërteta nuk vjetërohet, duhet të përmendet gjithmonë. Derisa ta kuptojnë thellë të vërtetën duhet. Familja Jashari nuk ka pagu për arkivole. Nëse dikush ka marrë pagesa, i ka keqpërdorë. Arkivolet i ka pagu Këshilli Komunal për Ndhimë Emergjente, bashkë me Këshillin për Financim që kanë funksionu si institucione shtetërore.

Arkivolet i ka dërgu Mevlyde Saraçi bashkë me Qemail Hajdar Agën. Në makinë të Lidhjes Demokratike, siç e thashë, ka qenë kryetarja e forumit Edi Shukriu, Profesor Doktor Fatmir Sejdiu, ka qenë Ramë Buja edhe Imer Reçica dhe kjo është e vërteta. E tani të ushqehen me të pavërteta nuk është mirë, sepse nuk i bën mirë familjes Jashari, komandantit legjendar, heroizmit të grave, fëmive, burrave që kanë luftu me ni ushtri të tërë. Prandaj, unë e ndjej obligim moral që të gjitha t'i them të vërteta. E thashë nuk kom mbri me bukë në Drenicë, na kanë pengu. Po nuk mund të them se unë nuk i kom dërgu arkivolet, është e vërtetë. Janë fotografitë, shkrimet, janë dëshmitë.

Anita Susuri: Kanë qenë 46 arkivole apo?

Mevlyde Mezini Saraçi: Jo, kanë qenë 86 arkivole.

Anita Susuri: 86?

Mevlyde Mezini Saraçi: Po. Edhe u kthymë, domethonë, atë mbramje në shtëpi. Në shtëpi nuk kishin informata. Qemail Hajdar Aga shkoi në drejtimin e vet, unë mbeta tek zyrat e LDK-së. Mezi arrita të kthehem në shtëpi sepse ishin nja 1500 metra largësi edhe ishte vonë, ishte rrezik sepse këdo që e gjenin në rrugë ata e arrestonin por arrita në shtëpi. Kur arrita në shtëpi, po e shoh bashkëshortin tim zgjuar, i mërzhitur. Tha, “I varrosën Jasharajt”. Beogradi kishte dhënë një lajm të rrejshëm se ishin varrosë, a në fakt kishin tentu t’i varrosin, kanë fillu por kanë pengu veprimtarët të cilët kanë qenë në negociata që të varrosen të nesërmen.

Pra, unë i kom dërgu arkivolet me datën 9 mars dhe me 10 mars [1998] ka qenë e caktuar data e varrimit. Unë nuk kam mundur të marrë pjesë në varrim sepse neve na kanë kthy dhe s’ka pasë teori që unë edhe një here të shkoj atje. Por, me rëndësi që unë e kam kry misionin tim, për atë që kam qenë e përcaktuar. Unë nuk kisha guxim t’i them Agimit që unë kam qenë i kam dërguar arkivolet, sepse kisha frikë që policia m’kanë ndjekë edhe vjen në derë edhe tash edhe atë të vërtetë me ia tregu Agimit. Por, dikur i thashë, “Agim, të lutem mos i dëgjo informatat”, tha, “Po këta thanë...” “Unë erdha prej Drenicës, nesër osht’ varrimi. Nëse mbrijmë të shkojmë me veprimtarët nisemi, por nëse jo, unë e kreu obligimin tim”.

Ai sikur nuk më besoi. Tha, “Në Drenicë edhe u ktheve”, ishte e pamundur të shkoje edhe të ktheheshe. Thashë, “Beso ose mos besoj”, “Nuk është ty që nuk po të besoj, por nuk po i besoj syve të mi”, “Është e vërtetë? U kthytë të gjallë”. “Po” thashë, “u kthym të gjallë sepse u detyrum për 15 minuta të kthehem”. E tani t’i përmend të gjithë veprimtarët që i kom taku aty, nuk mund t’i mbaj mend të gjithë emrat edhe pse më duket që po i shoh tani. Por, e kam obligim t’i përmend Ajnishahe Shala-Halimi, Bashkim Eminin, bashkëshorten e tij, ta përmend këta që kemi shku thashë, Anton Nokaj, ka qenë Rexhep Gjergji, kanë qenë edhe disa antarë tjerë të kryesisë, por jo të gjithë sa po proklamojnë sot. Domethonë, me detyrë me thirrje edhe me mundësi.

Unë besoj se krejt Kosova ka pasë dëshirë të jetë atje, por nuk ka pasë mundësi. Me rëndësi që ata që u dashtë kanë qenë në vendin e ngjarjes. Por, aty e kom taku delegacionin e Malishevës, ku kanë qenë dy gazetarët, Cen Desku edhe Jusuf Bytyqi që edhe Hoxha Fetah Bekolli. Hoxha Fetah Bekolli ka qenë protagonist i varrimit. Mbasi ka pasë edhe tjerë, por unë flas për ata që i kam pa. Edhe ai ka qenë shumë i lumtur kur kom mrrri me arkivole bashkë me Qemail Hajdar Agën, sepse Fetah Bekollin e kom njoftë në aktivitet. Ka qenë shumë aktiv përpara. Ka qenë hoxhë në komunën e Gjakovës, në fshatin... në ni fshat afër Gjakovës, në Rogovë të Hasit. Por, ka qenë veprimtarë i dalluar. Ai nuk ka ndejtë në petkun e hoxhës të bëj vetëm rituale, por ka nejt në petkun e aktivistit. Përveç ritualeve fetare, i ka kry të gjitha aktivitetet dhe ka qenë edhe i mobilizuar në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës.

Prandaj edhe Fetahu e ka përmend disa raste këtë të vërtetë. Dhe ai osht’ kontribut shumë i madh në varrimin e Jasharajve, po edhe të gjithë ata që kanë qenë pjesëmarrës. Tani unë u ktheva, puna ime ishte e vështirë, çdo ditë e më e vështirë. Kërkohej të siguroj ushqime, strehime, veshëmbathje, barna, kontrollet mjekësore për banorët që derisa unë isha jashtë pa u burgosë kish mrrri diku rreth 16 mijë

anëtarë të familjeve të ndryshme nga treva të ndryshme, po nga regjioni i fshatrave të Gjakovës ku po bëheshin luftimet. Të gjithë merrshin banesën për 40 minuta. Nuk kishte shansë ni familje, dilnim në periferi prisnim. Ka pasë mobilizim të jashtëzakonshëm.

Dy libra mbusheshin me shënime, ni me të ardhuna, tjetri me rezerva të familjeve, të ushqimeve. Ka pasë makina të panumërta vullnetarë që kanë bartë familjarë. Ka pasë mjekë të mobilizuar; është mobilizuar ambulanca “Nëna Terezë” për vizita. Nuk e di çka nuk ka pasë, Gjakova ka qenë si ni trup, ka funksionu gjithçka për mrekulli dhe unë natyrisht aktive pa orar. E kemi furnizu Gllogjanin, e kemi furnizu Jabllanicën. Vet kom shku në Jabllanicë, ni kamion me ushqime e kom dërgu në, ku ish fronti i luftës. Nga Rugova e Hasit nënkryetarja e Forumit të Gruas, Ganimete Shala, me veprimtarë tjerë kanë dërgu në Likoc ku kanë qenë pika. Kom dërgu në Rekë të Keqe me veprimtar të ndryshëm barna, ushqime, veshje. Krejt çka ka pasë nevojë. Domethonë, Ushtria Çlirimtare nuk ka pasë nevojë për ndihma po për furnizim dhe ktë e kemi kry. Ndërkaq banorët kanë pasë nevojë për ndihma sepse kanë qenë t’zhvendosun.

Tani aktiviteti u shtu, u shtu numri i aktivistëve, u shtunë obligimet e mia, u ngushtu rrethi i veprimtarisë sepse tanimë rashë n’sy edhe isha në çdo hap e përcjellun. Përpara derës time ka qenë ni serb me xhakët me katrorka i cili ka qëndru para ni shitores që shiteshin prodhimet e plastikës. Vazhdimisht ai e ka inçizu terrenin, çdo lëvizje, dhe policia serbe i ka pasë informatat. Po ka pasë edhe bashkëpunëtorë tjerë të cilët nuk i kom njoftë. Dhe ndodhi ni lëvizje në Prishtinë me datën 31 maj, unë vi në Prishtinë dhe shkoj e vizitoj zyrën e Kryqit të Kuq Ndërkombëtar dhe kërkoj të lirohen disa veprimtarë që ishin burgosë para meje në Gjakovë, si delegacion zyrtar. Po atë ditë e boj ni takim në zyrën amerikane, ku takohemi me zyrtarët e asaj zyre dhe kërkoj që Amerika ta sensibilizoj se Gjakova është në kaos, krejt Kosova, po unë obligimin tim e kisha për Gjakovën.

Atë ditë e kishim edhe ni mbledhje të kryesisë të Forumit të Gruas në Prishtinë, në lokalet e LDK-së, ku tani është muzeu, Shtëpia e Presidentit [Pavarësisë]. Mbaroi takimi dhe unë i tregova që Forumi i Gruas në Gjakovë ka vendosë me 1 qershor, Ditën e Fëmive ta mbaj ni protestë të madhe të grave të Gjakovës, para objektit të policisë të Gjakovës me moton, “Ndalni luftën, lironi të burgosurit politik”. Ajo ishte mbrëmja e fundit, ku të nesërmen duhej të përballesha me organizimin e protestës. Erdhën media të ndryshme ndërkombëtare, sepse ishin zbarkuar në Kosovë dhe unë dhashë deklarata diku për pesë-gjashtë televizione, agjensi ndërkombëtare që, “Nesër në orën 11:00 do të ndodhë protesta në Gjakovë”. E murë dhenë informata dhe unë u ktheva atë natë.

Kur u ktheva atë natë disi ni parandjenjë shumë e keqe më shoqëroi dhe i thashë bashkëshortit tim, “Agim”, thashë, “ma mirë të kishin marrë ty n’burg se mu”, thashë, “se unë vetëm po i shoh dyrtë e burgut”, tha, “Pse?” Thashë, “Tanimë për mu çdo moment është më i afërt për burgosje, sepse kisha kry aq shumë aktivitete publikisht pa u fshehur dhe tani përcjellje kisha n’çdo anë”. Edhe ai tha, “As ty, as mu. Mos u mërzit! Hajt se kanë ata njerëz ma të rëndësishëm se ti dhe unë”. Po unë veç e kisha ndje atë tmerr brenda, përbrenda meje. Të nesërmen në mëngjes u nisa, u veshja me veshje të terrenit. E

vesha ni setër të rrypit pak ma të trashë, i veshja ni parë çizme pak ma sportive po t'trasha. U veshja pak ma trash me veshje, se e dija që kanë me na rrah. Mendoja, unë që tash kur të mbijnë [rrahin], ato tesha do të më mbrojnë, rrobat. Po nuk të mbron rroba, dajakun nuk e mbron asgjë.

Dola te dera po du me bo përshëndetjen me Rrezartën, vajzën e madhe, dhe tha, “Mamë, ku po shkon kështu? Duhet të dukesh si grua, pse nuk vesh veshje si grua dhe t'i prijsh të gjithë asaj proteste të madhe? Kur janë mobilizu krejt Gjakova me rrethinë, e ti këtë veshje”. Kisha dilema, a t'i tregoj. Thashë i futet tmerri edhe ligështohet, sepse secili fëmijë ndjen dhimbje për nënën. Thashë, “Në rregull, po çka të vesh unë sot?” Edhe ajo m'i zgjodhi rrobat solemne të vishem unë, po mendoj, solemne zyrtare edhe të vishem me këpuca pak ma solemne, jo komode edhe unë të dukem si grua. Vërtetë derisa u nisa u doka si grua (qeshë).

Tani u nisa të vazhdoj rrugën për Lidhje Demokratike, në objektin në Gjakovë. Nga shtëpia dhe vajza ime Valmira nuk më lëshoi, “Unë do të përcjellë”. “Po pse? Unë gjithmonë kom shku vetëm”. “Do të përcjellë”. Më përcjelli deri diku dhe i thashë, “Kthehu!” Më shtrëngoi, më përqafoi aq shumë. Gjithashtu edhe Pranvera, ma e vogla, ishte nantë vjeçe, dhe me atë u përshëndetëm. Diamanti vetëm kishte dalë në shkollë edhe Heroina në shpi u përshëndetëm.

Agimi kishte dalë të kryen disa punë tjera të aktivitetit, sepse në atë kohë ai udhëheqte magazinën e Këshillit të Emergjencave, magazinë që bënin furnizimin e Ushtrisë Çlirimtare. Edhe ai me detyra të veta. Sapo ka dalë e ka ndalu dikush me bicikletë edhe i ka thanë, “Agim ta kanë burgosë bashkëshorten”. Në fakt unë sa mbrriva në zyre të LDK-së. Për pak çaste kishin ardhë ni delegacion i nëndegës së Skivijanit për të kërku ndihma për familjarët. Unë në moment po i thras disa organizata punuese që shisin miell dhe i thashë t'ia sigurojnë Skivijanit miellin ma afër, ju t'ia dërgoni mos të pengohen veprimtarët se mund të arrestohen.

Në bisedë e sipër po futen dy [policë] civilë deri te hyrja e zyrave të Lidhjes Demokratike në Gjakovë. Në moment u doli para vozitësi Fatos Efendija edhe ata i thonë, “Mevlyde Saraçi”. Erdhi Fatosi i zbehur në tavolinë ku po bisedonim me veprimtarët tha, “Mevlyde, ty po të kërkojnë”, thashë, “Në rregull”, thashë, “Fatos, po ta lo çantën”, se n'çantë e kisha ni letër me 200 emra të ndryshëm të barnave, nevojave për furnizimin e Ushtrisë Çlirimtare. Sapo e kisha marrë nga Fehmi Vula për ta dërgu në Prishtinë për t'i furnizu frontin e luftës. Për fat timin që m'u kujtu që e kam atë listë me katër faqe të formatit A4 dhe ia lashë. I thashë, “Të lutem fshehe këtë çantë edhe ia dërgon Agimit në shpi”, tha, “Në rregull”.

Unë e nxora letërnjoftimin edhe dola. Ata i kishin zgurdullu sytë, me veshje civile. Njëri prej tyre e hapi atë kartelën dhe tha, “Na kem autorizim me të arrestu”, thashë, “Jo, unë vij vet, s'ka nevojë me më arrestu”, tha, “Na e kem obligim me të marrë”. Edhe aty më arrestun, m'i vunë prangat. Nuk ish halli te prangat, as te burgosja, por çka t'i bëja protestës që ishin mobilizu krejt gratë e Gjakovës, dhe tani protesta u shtyp në start. U burgosa. Më dërgun në Polici të Gjakovës në ni kthinë të papastërt, të errët,

muret e mbushura me gjak. Më rrahen kafshërisht me kondak, me shkelma, me ato çizmet e tyre të luftës. Pastaj më dërgonin kohë pas kohe në katin e katërt me ashensor në një zyrë të mëmerrin në pyetje nga më të ndryshmet. Por, ata vetëm më merrnin në pyetje sepse unë asgjë nuk tregoja. Por krejt kohën e kisha mendimin çka ka ndodhë jashtë me protestën. E lusja Zotin të mos burgosen edhe gratë tjera. Por, dëshira ime ishte që protesta të vazhdon.

Për fat të keq nuk kishte vazhduar sepse ka mbijetu frika, por edhe Serbia e ka shtypë protestën se ka qenë guxim në protestë para policisë. Policia kriminale, na me durë në xhepa. Por, ka qenë guxim edhe vendosshmëri. Për fat të mirë atë ditë nuk osht' burgosë askush tjetër përveç meje. E tani për atë pjesën kur e kanë marrë informatën fëmijë e mi, ajo është e tmerrshme. Ata kanë shpjeguar, ata dijnë ma mirë të flasin, por unë di të flas për botën time. Më shumë isha e thyer shpirtërisht, sesa kisha dhimbje fizike. Sepse shpirtërisht mu ma ndaluan veprimtarinë. Unë kisha dëshirë të jap më shumë kontribut, nuk i mungoja vetëm familjës e fëmijëve të mi, po për mua ishte Kosova, familja e madhe.

Unë tani me në kthinë ku ishte temperatura diku minus 15, 16 gradë, ishte shumë ftohtë. Mbante edhe kohë e ftohtë edhe jashtë, por brenda në ato kthinë, në ato qeli. Unë isha me çorape shumë të holla me atë veshje solemne që më dukej sikur jom e mbështjellun me në letër të hollë. Kisha ethe, temperaturë, sepse nga rrahjet më nuk e dija as çfarë moti po mban...

Anita Susuri: Ishte 1 qershor data a po?

Mevlyde Mezinë Saraçi: 1 qershor. Dhe unë i kisha marrë këpucët, m'i kishte dërguar motra përmes agjencive përpara, para në kohe dhe unë njërin këpucë e hiqja nga këmba dhe ulesha në karrigë. Po më pihej këmba pa këpucë. Pastaj kur ngrihej këmba e djathtë e vendosja këpucën e djathtë, e hiqja të majtën ulesha të majtën po ndihej edhe e majta. Ngrinin durë. Ngrinin nofullat. Ftohtë. Pastaj nxehesha sepse vinin duke më tërheqë edhe në katet e larta duke më rrahur. Edhe atje duke më rrahur.

Dy policë edhe në komandant i policisë ma vuri bombën me siguresë të hekurit mbi kokë. Këndeje më sollën bukë të më japin me dhunë. Unë nuk e pranova bukën. Vdekja ishte më mirë për mua në atë kohë, pse të jetoja? Më lehtë isha të vdisja se të torturonin. Edhe kisha marrë në vendim. Edhe prej natyrës edhe prej lindjes jam një tip që vendimet e mia nuk mund të mi thejnë. Mund të mi marrin çka kam tjetër edhe jetën, por vendimet jo. Edhe nuk pranova asgjë. Nuk pranova për veprimtarët të cilët kanë bashkëpunuar me mua, për terrenet. U solla si në grua amvise që gatuaj, ziej, kujdesëm për familje, por ata i kishin informatat.

Katër ditë e katër netë jam rrahë pa mëshirë në Gjakovë. Me rregulla ata vetëm 72 orë kanë pasë të drejtë, por ata më kanë majtë edhe në ditë më tepër. Nuk më kanë lejuar kontakt me familjen dhe ditën e katërt më kanë dërguar në burgun e Lipjanit. Unë kom qenë me në makinë të blinduar por e di...

Anita Susuri: A e keni ditë ju ku po shkoni? Çka po ndodhë?

Mevlyde Mezini Saraçi: Jo. Unë kom mendu që në Serbi po edhe aty kishte qenë burgu serb, nisoj. Kur udhëheqet prej serbëve ishte njësoj, burg të vdekjes, burgu hetues më i tmerrshëm në Kosovë. Dhe më dërgun. E dëgjova që thanë, “Kjo duhet të dërgohet në burg”, por jo ma tepër. Tani rrugës dëgjoja krisma, luftimet po vazhdonin nëpër terrene të ndryshme, dhe ata nuk kishin nga të më dërgojnë në Lipjan, më dërguan në burgun e Prizrenit. Burgu i Prizrenit diku në hyrje, afër, e dini të gjithë ku osht’ edhe Gjykata e Prizrenit.

Donin të më linin aty për shkak të rrezikut të zyrtarëve serbë policorë, të cilëve u rrezikohej jeta e tyre nga Ushtria Çlirimtare. Nuk e kishin hallin tim. Por, Prizreni nuk më pranoi sepse tha, “Nuk kemi burg për gra”. Dhe ju tha këtyre dy policëve që, “Kjo mbetet në makinë dhe ju duhet ta dërgoni”. Dy orë kom qëndru në oborr në atë makinën burg me grila, ku kalonin qytetar të ndryshëm që i merrnin në pyetje po edhe qytetarë tjerë. Të gjithë më shikonin, sigurisht nuk kanë mundur të më identifikojnë, por është pa që dikush është aty brenda. Gjatë dërgimit në burg m’i kanë lidhur edhe këmbët edhe duart të mos iki. Por, unë ni gru e paarmatosur, e rrahur, e dërmuar, ku kisha të ikja.

Megjithatë, mendoja rrugës këto krisma, dhashtë zoti del dikush prej ushtarëve t’i vret kta dy edhe unë t’i bashkohem Ushtrisë Çlirimtare. Po kta me atë sugjerimet që i merrnin, me informacione nga baza më kthyen në drejtim tjetër dhe arritën përmes rrugëve dytësore t’më dërgojnë në burgun e Lipjanit. Unë nuk e di nga më kanë dërguar, sepse kam qenë e mbyllur edhe nuk kam mundur me pa rrugën, por kur kom hy te hyrja e burgut ashtu me zinxhirë në këmbë e duar më kanë lënë te dera që të vuaj më shumë, dhe të burgosurit tjerë të më shikojnë si po më dërgojnë mua.

Pjesa e Gjashtë

Mevlyde Mezini Saraçi: Oborri i burgut kishte çelë si ni lulishtë, sepse të burgosurit i kanë shfrytëzu për ta punu oborrin, për ta pa ni pamje të bukur. Kjo ka qenë ni maskë e Serbisë që të mendojnë se e kanë lulishtë edhe brenda. Edhe unë mendova, më kanë pru në lulishtë, po më rrahin e burgosin në lulishtë. Por, ajo zgjati veç dy-tre minuta derisa arrita te pranimit i Burgut të Grave në Lipjan. Aty u ballafaqova menjëherë me ato gardianet e tmerrshme serbe, ato kriminele që e krynin misionin e tyre në formën ma të vrazhdë. Por, mes tyre kishte qenë edhe ni shqiptare.

Unë në atë kohë nuk muja ta merrja me mend se si ni shqiptare punon police në burg, ishte e pakapshme. Dhe ajo detyrohej të fliste në gjuhën serbe për faktin për ta kuptu zyrtaret tjera, se ishte atëherë vetëm gjuhë zyrtare. Dhe unë refuzova të ju përgjigjem, tregova kokëfortësi. Ajo më luti, m’i merr shënimet, të shkoj në dhomën t’i ndrroj rrobat. T’i marrë ato veshjet e burgut e ta bëj ni lloj pastrimi, sepse atje katër ditë në qeli as s’kam ngrënë, as s’kam pirë, vetëm jam rrahur. Unë refuzova të gjitha. Pastaj kur më dërgoi në dhomë mi tha dy-tri fjalë shqip. Tha, “Unë jom Sanija, jom Sanije Bytyçi”, tha, “kom sakrifiku vetën edhe familjen për t’i ndihmu të burgosurat politike. Jom po e

burgosur aq sa ju, po mundohem të jep kontribut”. Unë e shikova me mëri edhe nuk munda ta përceptoja fare dhe refuzova. Ajo insistoi tha, “Të lutem kuptom, unë jom për ju këtu”.

Kaluan disa ditë, unë nuk desha as të pranoj komunikim as kurgjo, por ma vonë e kuptova. Ajo e kishte informuar përmes mekanizmave të saj kryesinë e LDK-së, e kryesia e LDK-së familjen time që unë jom në Burgun e Lipjanit. Sepse për 17 ditë familja nuk e kanë ditë ku jom, a jom në Serbi, a jom në qeli në Gjakovë apo më kanë vrarë apo ku jom. Kjo ishte informata e parë kur ma solli Sanija. Tha, “Unë kom komunikim me Naser Osmanin. I kom tregu dhe Naseri i ka lajmëru familjen tënde dhe ata të kanë dërguar shumë të fala”. Eh, po, mirë shumë. Atëherë edhe e ka bërë ni komunikim përmes motrës time në Prishtinë dhe kur më ka sjellë informata të vërteta prej familjes time atëherë e kom kuptu se Sanija osht’ në burg për të na ndihmuar neve, dhe vërtetë na ka ndihmuar.

Por, nuk ka mund ta pengoj atë dhunën edhe terrorin që kemi pasë. Burgu, burg. Burg serb, burg hetues, burg i tmerrshëm. Unë isha ish deputete e kuvendit, kryetare e emergjencave, kryetare e Forumit të Gruas, kryetare e kryesisë. Me njiqind funksione të cilat nuk të jepnim emër, por obligim e sakrificë. Për ata unë isha person i duhur që më kishin zënë dhe mandej ato torturat tjera vazhduan. Aty në burg i kom taku edhe tri studente të Prizrenit, Behare Tafallari, Jehona Krasniqi edhe Leonora Morina. Të trija studente kanë qenë në fillet e para të UÇK-së, kanë përgatitë atë anën shëndetësore, kushtet e ndihmës të parë dhe i kanë zënë duke ushtruar edhe ato kanë qenë në burg me mua.

Ka ardhë pastaj [Zahrije Podrimqaku](#) nga Drenasi edhe atë e kanë torturuar pa masë. Ni muaj pas meje erdh Fatime Boshnjaku, të cilën e kanë zënë duke ndihmuar luftën. Ka qenë Gjyke, s’po më kujtohet mbiemri po Gjyka nga Regjioni i Gjakovës, po ashtu edhe ajo ka ndihmu luftën. Ka pasë edhe dy gra tjera me të cilat s’kam arritë t’i njoh në burg, por kemi qenë disa të burgosura politike. Ato janë mundu në çdo moment që neve të na krijojnë skena, që ne të tentojmë të ikim e të na nxojnë duke ikë për të na vrarë. Ne kemi qenë të kujdesshme, kemi ndihmu njëra-tjetrën aq sa kemi mundur.

Për mua Sanije Bytyçi e ka lujtë rolin e heroinës, sepse unë kom bërë edhe grevë urie. Gjashtë muj ditë nuk kom ngrënë ushqim të burgut. Por, kom hupë aq shumë kilogram, kom qenë aq dobët me shëndet por i kom dhënë vetës detyrë. Nuk du të ushqehem me ushqim të burgut, nuk e du ushqimin e Serbisë. Për mu ushqim ka qenë liria, aktiviteti, e jo ushqimi. Prandaj, familja osht’ detyru të më sjellë ushqim çdo dy javë dhe me atë ushqimin që ma ka sjellë familja unë e kom shty. Shumë herë ma kanë refuzu, ma kanë hudhë. Shumë herë më kanë detyru ta ha krejt ushqimin përnihërë që ka qenë e pamundur. Por për të mos e kuptu që unë nuk e ha ushqimin e burgut, Sanija më thonte, “Vendose gjithë bukën në gjellë që mos derdhet gjella e pastaj mbështjelle me gazeta”, që na binin.

Unë kom lexu gazetatat serbisht, i kom kërku shqip, m’i kanë ndalu dhe ato serbisht m’i kanë leju me cenzurë, i kanë pre lajmet ma të rëndësishme. Tani ato gazetatat ishin me leje dhe unë i mbështjellsha ushqimin, gjellën me gjithë bukë të përzier edhe i hidhnim nëpër kanta të bërlllogut, për të mos e kuptu që nuk e ha. Mirëpo, ato kishin nuhatë mënyrën, se ushqimi im ku po përfundon. Për fat të mirë

pshtova prej tyre, por nuk pshtova prej torturave tjera. Këto ishin momentet ma të vështira në burg kur nuk kishe të drejtë asgjë, as të mendoje shqip. Kishe mundësi tanë ditën me ato provokacione, me ato sjellje. I kanë rrahë të burgosurat, ma shumë e kanë rrah Zahrijen edhe Beharen, e kanë rrah edhe Fatimen, neve na kanë torturu psikikisht çdo sekond.

Çdo sekond kemi qenë në rrezik për vdekje. Me mu ka pasë ni obligim njëra prej gardienëve që të më zënë, sepse ka dëgju Sanije, gardianja Sanije ka dëgju që, “Po presim këtë ta gjejmë në ni moment”. Unë kom dalë, nuk e di as vet, ato grilat e dritares jom afu, ka qenë e ndaluar. Aty jo që kemi mujtë me pa diçka, por nëpër grila, po thjeshtë...

Anita Susuri: Jeni afu te grilat.

Mevlyde Mezini Saraçi: E ka dëgjuar zërin tim edhe për ni sekond e ka hapë derën me shpejtësi edhe me kondak drejt te unë. Unë u zura ashtu qysh isha, sepse nuk e dija as vet si u gjenda në këmbë në kohën kur u detyrojshim me qenë ulur. Ishim të caktuara krejt ditën çfarë të bëjmë, jo të jesh në dhomë në qeli e të ngritësh të ecësh, të caktuara. Kemi pasë për detyrim me komandën edhe me kontrollin e tyre të rreptë. Thashë, “Asgjë”, tha, “me kë komunikove jashtë?” Thashë, “Me kë ka me komunikue jashtë? Hiç s’po më duket komunikim. Unë jam brenda dhe përtej burgut ku ka me shku?” Dhe ajo m’u kërcënu shumë dhe ma vonë e gjeti momentin Sanija dhe erdh i tha, “Të lutem vetëm mbylle gojën, mos komunikue. Trimninë tënde ruaje për përjashtë, këtu mos e rreziko vetë. Sepse këtu po e gjejnë momentin, po dojnë me ardhë”.

Masnej ka pasë inskenime të ndryshme për me na vra. I kanë ndalë dritat, kanë gjujtë poshtë, po mendoj, ka pasë të shtëna poshtë, kanë ardhë i kanë përplasë dyrtë, na kanë bastisë dhomat, na kanë tmerru në çfarëdo kohe që kanë dashtë. Ka qenë tmerr edhe qëndrimi gjithëditor pa banjo. E kemi pasë të caktuar në mëngjes në banjo pesë minuta, në drekë para se të hajmë drekë edhe në mbrëmje në ora 6:00 ka përfund. Por, nevojat fiziologjike nuk kanë orar dhe ne kemi qenë të shtrënguara të përdorim edhe mjete ndihmëse në ni ambient jo higjienik. Sepse nuk kryhen nevojat në dhomë, por këto kanë qenë torturat e burgut.

Vizitat i kemi pasë ni herë në dy javë. Momente ma të vështira kanë qenë takimi me familjen. E dhimbshme, e dhimbshme sepse familja duhej të kalonte gjithë ato barriera nëpër rrugë e të vinte të më shikonte mu në burg. E të gjithë ishin, fëmijtë e mi e bashkëshorti im. Po kanë ardhë rregullisht. Janë ndrru ashtu siç ua ka leju Gjykata e Pejës. Kanë ardhë më kanë vizitu dhe neve na kanë bërë vizitat me ni dhomë ku ngjante si dhomë e mirë, dhomë e ditës. Ni tavolinë në mes, në dy anët me karrige, nuk ka pasë gjurmë të burgut aty. Ajo ka qenë ni mashtrim optik për familjarët. Me ni moment po vijnë në vizitë motra e madhe nga Mitrovica, Melihatja, Agimi, Valmira vajza ime edhe po më thotë motra, “Po ky nuk qenka burg”, thashë, “Jo, nuk osht’”. As nuk kisha guxim t’i thoja osht’ burg apo nuk osht’ burg, po as nuk doja ta mërzisja.

Tha, “Tash unë po shkoj ma e qetë, se ti e paske pak ma mirë, vetëm që e mbyllun. Mos u mërzit, Kosova lirohet edhe ti lirohesh”. Kur shpërtheu në vaj Valmira, se ajo ka pa grilat, i ka pa edhe e ka ditë që jom në burg, i kanë spjegu edhe tjetër, ka lexu. Edhe qau shumë, tha, “Si nuk është burg?” Gardianja atëherë Sanija qëllloi në atë vizitë edhe i tha, “Çka po kërkon ti?” Tha, Valmira i tha, “Mbylle gojën!” Ajo tha, “Si guxon të më thuash mbylle gojën, jam police”, tha, “Puna madhe që je police”. Atëherë Sanija meqë nuk pat’ ndonjë kontrollë tjetër të policisë ishte vetëm ajo me neve buzëqeshi edhe tha, “Edhe unë jom police, po ti qenke ma e zoja se nëna yte”. Edhe Valmira ashtu me vajin e të qara u përshëndetëm e shkoi. Ishte vështirë.

Tani më kanë ardhë edhe familjartë e tjerë, por Pranverën nuk ma lejonin në vizitë. Pranvera ishte ma e vogla edhe e kishta harru pamjen e Pranverës. Sepse fëmijtë i shihsha, mrena mujit i shhisha dhe e kërkoja Pranverën. Policia serbe për inat nuk e kishte dhënë lejen të vijë Pranvera në vizitë. Dhe unë herë e menoja të rritun, herë të vogël, herë foshnje, asniherë nuk më shkonte mendja ta shikoja ashtu siç u përshëndeta herën e fundit. Dhe sapo i hapja sytë, sytë e Pranverës vizatoheshin në dritare, në grila, por u coptojshin në mijëra pjesë se grilat ashtu ishin. Edhe unë krejt ditën kom qenë e shoqëruar me sytë e Pranverës. E shkrujta ni poezi, “Sytë e Pranverës” (qan). E shkrova në mendje (qan).

Anita Susuri: A doni me pushu pak?

Mevlyde Mezini Saraçi: Jo. Në mendje. E kishim të ndalume lapsin e letrën. Ma shumë vuaja sepse më duhej ta përsërisja në mendje që të mos e harroja (qan). Nga ana tjetër, më kishte marrë malli për Pranverën po ndjeja dhimbje pse m’i burgosë sytë e Pranverës. Nuk i mjaftonte burgu im, mu më dukej ashtu. Gjatë gjithë kohës deri jam liruar, sytë e Pranverës më kanë shoqëru në grilat e burgut. Pastaj për fat të mirë munda ta mbaj në mend atë poezi. Edhe sapo u lirova prej burgut e botova librin e parë, “Sytë e Pranverës” dhe disi ishte si ni shpagim për fëmijërinë e saj.

Nuk qaj për vujtjet e mia, qaj për fëmijtë. Jo vetëm të mitë, por edhe të Kosovës. Mbase familja Jashari edhe shumë familje tjera, mijëra fëmi të tjerë e kanë dhënë jetën. Por edhe fëmijtë e mi e kanë dhënë kontributin, sepse kanë qenë të rrezikuar çdo sekond. Sa herë është bastisë shtëpia, sa herë ma kanë marrë bashkëshortin, djalin, mua. Në burg, në vizita, në aktivitete, domethonë fëmijët e të gjithë Kosovës kanë jetuar pa fëmijëri. Prandaj, ndjehem si nënë e lumtur që ata kanë arritë të më kuptojnë. Sepse në vizitën e parë që ma bëri vajza, Rrezarta, ishte më e madhja edhe tha, “Mamë, qëndro krenare, gjithë Kosova po të përkrahë. Në të gjitha organizmat po përshëndetet puna jote edhe prej të gjithëve ki përkrahje. Mos u mërzit”.

Gjithashtu, përkrahje kom pasë prej tre avokatëve të mi. Njërin avokat ma ka porositë Sevdije Ahmeti, tani e ndjerë, ka qenë kryetare e shoqatës për ndihmë grave edhe e ka organizue Lirie Osmani. Lirie Binishi Osmani ka qenë njëra prej avokateve. Ndërkaq, bashkëshorti im e ka siguru ni avokat nga Prizreni, [Rexhep Hasani](#) si dhe nga Peja, Shefqet Deçani. Shefqet Deçani e kishte pasë edhe babën të burgosur edhe vet kishte qenë i burgosur. Prandaj, ai vet kishte informata të jashtëzakonshme edhe

brenda edhe jashtë burgut, gjithashtu edhe avokati i Prizrenit. Dhe kështu që, unë kisha mundësi brenda dy javësh ta kom vizitën me familje dhe tri vizita të avokatëve. Disi më mbanin gjallë ato vizita, por kërkesa ime ishte, “Du të lirohem nga burgu, nuk më intereson”.

Kur erdhi Shefqet Deçani në vizitën e fundit, “Zonja Mevlyde, ti mund t’i paraqesësh padrejtësitë, dhunën që po ta shkaktojnë, por për t’u liruar është punë e imja” tha, “unë vetëm po të tregoj që liria nuk është larg”. Ka qenë trim, guximtar. Tha, “Ti qëndro e forte”, tha, “ne punojmë për ty. Mos mendo për lirinë”. Ndërkaq, kur erdhi Rexhep Hasani prej Prizrenit më rrëshqiti loti edhe ai u pikëllu. Tha, “Unë jom i pafuqishëm për ta ndalë lotin, por nuk jom i pafuqishëm që të punoj për ty. Por, për ty po punojmë të gjithë brenda edhe jashtë. Mos u shqetëso”. Kur vinte Lirie Osmani ishte si ni melodi. Prej katrorkave përreth burgut që nuk e di si duken, por më duket që ashtu kanë qenë siç i kom ndjerë, dëgjoheshin taket, këpucat e saj. Në momentin kur ishte koha e vizitës i ndëgjoja taket, atëherë e dija që do të dal prej dhomës dhe do të takohem me Lirien, do të marrë informata.

Lirie Osmani na mbante vullnetin se ishte avokate edhe e imja edhe e Zahrije Podrimqakut. Dhe thonte, “Mos u shqetëso, barrierat po hiqen”, nuk kishte guxim të tregonte të gjitha po, “koha po merr e mirë, rrugët po happen”, dhe unë e shihja lirinë. Më thoshte, “Unë do të vi sa herë që kërkon, por edhe unë jom e rrezikuar”. Me ni rast i kam kërkuar të vijë Nekibe Kelmendi. Ka ardhë Nekibja, por e kanë penguar, nuk e kanë lënë të më vizitoj. Ndërkaq gëzimi ma i madh për të burgosurat në atë kohë, se qajo ka qenë mundësia, ka qenë vizita e Kryqit të Kuq Ndërkombëtar.

Ditën kur erdhi Kryqi i Kuq kishte pasë leje nga organet shtetërore të ish-Jugosllavisë që të na vizitoj. Dhe ata na dërguan poshtë në sallën e takimeve, ku unë e di që kom qëndru gjashtë orë në intervistë me Kryqin e Kuq. Jo që kemi bisedu gjashtë orë, por na ka lënë të lirë, na ka zgjatë biseda për të na mbajtur pak të lira. Aty na kanë dhënë nga ni kartelet të antarësisë, ku dëshmohet që jemi të burgosura edhe jemi vizitu. Por, kurrë nuk e kom pa ma atë kartelë, menjherë na kanë marrë. Aty përkthyesi ishte, po ai [i njejt] përkthyesi që kishte qenë me mu në Drenicë që u ndalua në Komoran. Në momentin kur më pa u pikëllu shumë, por nuk kishte guxim të shprehej nga përfaqësuesit e Kryqit të Kuq Ndërkombëtar. Vetëm më tha, “Mbaje mend, unë jom ai. Të lumtë për vepra!” Tash, “Unë jom ai”, nuk e disha kush osht’ ai. “Unë jom ai”. Kisha... nuk mund ta përceptoja Kryqin e Kuq me atë, se unë si figurë vetëm ni herë e kisha pa.

Por, duke menduar ditë me radhë, ditë e netë atëherë e lidha se ky përkthyesi i Kryqit të Kuq paska qenë me mua në Drenicë. Ka ndodhë me të edhe ni takim me të ma vonë mas luftës edhe më nuk e kam parë. Por ai na dha kurajo edhe të gjitha të burgosurat atë ditë patëm shansën të takohemi me persona ndërkombëtarë, të flasim të gjitha ankesat tona, sepse kushtet kanë qenë tmerrshme, sjelljet kanë qenë të tmerrshme edhe për çdo mëngjes kemi pritë kur po na dërgojnë në Serbi. Por, fati e deshti që u organizuan edhe organizmat ndërkombëtare edhe të tri studentet një muaj para meje i nxorën me apele ndërkombëtare. Ndërkaq, për mua kanë punu shumë organizatat ndërkombëtare, por ato s’kanë punu vet. Ka punu Doktor Edi Shukriu me Forumin e Gruas, ua ka dërgua letrat të gjitha

organizmave ndërkombëtare, madje edhe Kofi Annan. I ka dërguar edhe një organizatë ndërkombëtare me seli në Itali, të cilët i kanë dërguar Millosheviqit letër edhe kushtëzim që gjatë takimit tim të marrin pjesë organizatat ndërkombëtare.

Të gjitha këto dokumente i kom, i ruaj. Dhe mua më kanë ndihmuar që të mos ngritet aktakuza. Kom arritë të lirohem me ndërmjetësim të organizatave ndërkombëtare, sigurisht edhe përpjekjes së avokatëve, por edhe mungesës së dëshmimeve. Sepse unë nuk kom pranë asni dëshmitar. Të gjitha dëshmitë e Serbisë i kom refuzu. Gjatë burgosjes pra ka qenë nifare rregulli, ligj, i ish-Jugosllavisë që nëse nuk arrihet të përgatitet aktakuza brenda 180 ditëve janë detyru të të lirojnë. E unë e kom pasë fatin që para burgimin ta kom së pari për 30 ditë nga Gjykata Komunale e Prizrenit. Herën e dytë më kanë dërgu në Prishtinë në Gjykatë të Qarkut të Danica Marinkoviç, krye kriminelja që ende jeton dhe është prapë krye kriminele. Ka bërë gjykimet më të rënda dhe ka dorë në krimet shqiptare, e cila s'më ka leju të përgjigjem në gjuhën shqipe, as në prani të avokatëve, por me tortura më ka detyru të jep deklaratë.

Por, prapë, për fat unë i kom dhanë deklaratat të cilat i kom, që nuk kam pranë asni vepër për askënd. Dhe herën e tretë, mu më është vazhduar paraburgimi prej Gjykatës Supreme të Serbisë dhe për mua ai ka qenë vendim i tmerrshëm, sepse kur të merret Gjykata Supreme e Serbisë me ni rast si unë si terroriste që kom furnizu edhe ndihmu Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, parashihej dënimi dhetë vjet deri në burgim të përjetshëm. Mirëpo, unë isha e sigurtë që Kosova nuk do të mbetej përjetësisht në burg. Kështu që, liria ime ishte kushtëzuar me lirinë e Kosovës.

Kur përfundoi dita e fundit, 180 ditë, gjatë gjithë ditës pranë grilave të burgut ka pritë biri im Diamandi, bashkëshorti Agimi, djemtë e hallës, [Burhan Kavaja](#), Rasim Kavaja, Rexhep Kavaja, të gjithë kanë pritë mos po lirohem dhe të më dërgojnë në Prishtinë. Sepse ka qenë edhe ni rrezik pastaj pas lirimit ku do të shkoj, se unë kom qenë në ni teren të panjohur. Mirëpo, nuk ndodhi. Mbaroi orari zyrtar edhe unë e humba çdo shpresë. Kur përfundoi ora 4:00, e dita që unë do të mbetem në burg derisa të lirohet Kosova edhe do të ngritet aktakuza. Mirëpo, presioni ndërkombëtar i ka detyru gjykatat që përmes edhe avokatëve të mi, që Gjykata e Pejës të merr vendim për lirim, sepse nuk ka arritë të ngritet aktakuza brenda afatit ligjor.

Në atë kohë bashkëshorti im ka qenë... ditën kur, domethonë ka komunikuar me avokatin, i kanë tregu që do të lirohem pas orarit të punës. Tani ky gëzim i im u shkurtu. Erdhi shefja e gardianëve që nuk më kujtohet emri saj, e ka pasë sjelljen e mirë me shpirt kriminel. Por, për të dhënë ni kozmetikë, ni përshtypje edhe tha, "Zonjë, të ka marrë malli për familjen?" Thashë, "Jo", tha, "A don me shku në shpi?" Thashë, "S'o problem i jemi me shku në shpi, kur të vjen koha shkoj". Edhe e kish pasë ni letër të palume, po kishte qenë ajo pjesë pjesë format A4 vendimi, diku rreth dymbëdhjetë faqe. Vendim për burgun. Ndërkaq, për mu vetëm ni kopje. Por nuk ma dha asni dokument, vetëm ma tregoi. Tha, "Sapo mbriu me faks ni dokument. Ti je e lirë, pesë minuta i ki kohë jashtë dyerve të burgut". Unë as nuk e dija si duket burg, si kam ardhë atë ditë më kanë futë e kom pa atë lulishtë edhe ma tepër...

Tha, “Tash do të përcjellë gardianja, ndonjëra nga gardianet edhe vetëm pesë minuta”. Pesë minuta nuk kisha kohë as me u përshëndetë me shoqet e dhomës, as me marrë asgjë prej shpisë. Atëherë, po ju thom shoqeve, “Ti mbaje këtë veshje, ti këtë, ti këtë”. Vetëm disa enë plastike i kom marrë me veti që jom ushqy në burg. Se ka qenë edhe karakteristikë ushqimi im, jom ushqy me lugën time plastike, me ni pjatë të pastikës, s’kom dashtë me përdorë as pjatat e burgut. Dhe ato i mora me vete dhe tasin plastik. Madje, madje, tasin e kom pasë si mjet shërimi kur na kanë ngrënë shumë ato insektet e vogla gjatë verës që ka pasë burgu, ka qenë ni torturë e veçantë. Unë i ujitsha durë për m’i shpëtu prej të enjturave prej insekteve. Dhe atë tasin e mora. Pak, shumë pak gjëra të mia personale edhe dola te dera e burgut.

Kur dola te dera e burgut, mbeta me ni çantë, kah të shkoj. Nuk e dija unë ku është burgu, as kah më kanë pru. As s’kisha para me vete, as transport, as asgjë. Ata kishin shku që më kanë pritë tërë ditën, sepse mbaroi orari, dhe me vonesë, mbas dy orëve, pasi ka përfundu orari zyrtar [më lëshuan]. Aty kishte qenë ni objekt, ni kafiteri, aty kriminelët. Dhe unë u futa, nuk kisha rrugëdalje. Edhe ni kamarier i burgosur po thotë, “Zojë çka po don?” I thashë, “Ni kafe”. “A ki me çka me pagu? Jo”, tha, “nuk shërbejm na”, “Po mirë”, thashë, “a bon pesë minuta”, “Po”, tha, “çka don me bo pesë minuta?” Thashë, “Nuk e di. Por, jom liru duhet me shku në shpi”, tha, “Unë jom i burgosun, shërbej këtu” tha, “ik sa ma parë”, tha, “se i njeiti burg osht’ edhe këtu”.

Unë tash e kom kthy shpinën po du m’u kthy n’drejt kah dera m’ka nalë dy durë mrapa me më përshëndetë {bën me duar tek supet}. Unë mendova që tash erdhën përsëri policia dhe thashë përfundoi epoka ime, dhe tash jom në durë të pasigurta, prapë në burg, kom qenë në regjistër si e burgosun, ka pasë dëshmitarë. Dhe e kam kthy kokën, kur e kom pa djali hallës, Rexhep Kavaja. Kur e ka lajmëru burri që Mevlydja osht’ liru, më lajmëroi avokati ai ka qëllu në rrugë informatë mas informate ka ardhë me makinë shi i madh, tmerr. Ka udhëtu si pa kokë edhe nuk kemi mund të flasim, veç në përqafim. Ai më ka përqafu, më ka fut në makinë edhe krejt kohën kemi qarë bashkë. Dhe drejt më ka dërgu te banesa e Burhan Kavajës, te djali hallës, sepse e kom pasë hallën gjallë.

Ata e kishin pregatitë drekën. Por, para se të ngjitem në banesë, djali tjetër i hallës, Rasim Kavaja që ne e qujmë Ramadan, kishte pasë bisedu me ni që i shkurton floktë, me ni frizer i cili i kishte thënë, “Nëse ju keni qasje, kur lirohet prej burgut du me ia pre floktë që mos me çu në familje me pa me ato flokë”, qysh m’u kanë rritë në formë të parregullt, të tmerrshme në burg, “Të mos tmerrohen se osht’ ni pamje e tmerrshme për fëmijtë me të pa ashtu”. Edhe po më thotë, “Te frizeri”, thashë, “Jo”, isha liru prej burgut, unë me shku te frizeri, tha, “Jo për frizurë, vetëm t’i shkurtojmë pak floktë”. Edhe më kanë çu shpejt e shpejt, m’i kanë la floktë, m’i kanë shkurtu edhe kom shku te halla, domethonë, te Burhani. Edhe e di kur e ka marrë telefonin, Burhan Kavaja e ka lajmëru Enver Malokun, tanimë i ndjerë, edhe i thotë, “Enver, u liru Mevlydja”, ai i thotë, “Ma jep Mevlydën”. Ai u gzu shumë edhe tha, “Besom, po qaj prej gëzimit”.

Tani unë e kisha hallin si të shkoj në Gjakovë të fëmijëve, se fëmijëve pritshin. Mirëpo, ka qenë një strategji e avokatëve të mi që mu më ka dalë pozitive. Atë natë t'mos udhëtoj, sepse Serbia më ka liru jashtë orarit të punës në mënyrë që të më zë dikush rrugës të më ekzekutoj. Në mënyrë që nuk ka përgjegjësi burgu. Edhe unë insistoj gjatë gjithë kohës, “Sonte dua të kthehem në Gjakovë”, “Jo”. Arriti edhe avokati, Shefqet Deçani edhe Agimi, bashkëshorti im, edhe atë natë e bëmë gjumin te djali hallës. Edhe të nesërmen në mëngjes, Rexhepi, i cili erdhi më mori te Burgu i Lipjanit me makinën e vet më ka dërgu deri në Pejë. Pastaj, për t'i hupë gjurmët në Pejë kemi ndalu në shtëpinë e avokatit një dy orë e për mu ishin shekuj se unë doja t'i shikoja fëmijëve. Atëherë, prej aty në autobus deri në Gjakovë.

Autobusi në Gjakovë nga Peja kalon nga dera ime. Kur kom mbërri te dera i kom thanë, “Ma ndalë këtu” (qan), ai vozitësi mbetë. Thashë, “Unë jom e burgosun, jom liru”. Edhe e kom harru atë çantën me disa gjëra të mia personale. Edhe ai e kapi vozitësi krytë në dorë, po më sheh gru e dobtë, e lodhun, e dërrmuar edhe shkoj. Kur hyra në oborr kishin ardhë me më pritë jashtëzakonisht shumë njerëz, fëmijëve e mi, ato takime të tmerrshme. M'i ka xhiru vajza e fqinjëve, Zana, e cila jeton në Norvegji me atë kamerën e madhe po në formë...

Anita Susuri: Amatore.

Mevlyde Mezinë Saraçi: Amatore, po. Edhe me lëvizje, po i ka inçizu ato momentet e para të takimit me fëmijëve e mi te dera e oborrit deri në hymje. Ka qenë një moment gëzimi edhe pikëllimi, se unë i lash edhe disa shoqe në burg. Unë u lirova, po nuk u lirova komplet. Edhe vazhdun torturat. Vetëm dy ditë unë i kom qëndru në shpi, kom pritë mysafirë edhe prej ditës të tretë pas lirimit kom vazhdu aktivitetin, nuk e kom ndërpre. Edhe pse e kom pasë të kushtëzuar edhe e kom dokumentin që, “Hetimet nuk kanë përfunduar, hetimet vazhdojnë”. Por, unë kom vazhdu punën edhe aktivitetin deri në çlirimin e Kosovës. E tani ka ngjarje tjera kur kanë ardhë Serbia me më likfidu me datën 27 mars, në mbremje...

Anita Susuri: Në vitin '99 a po?

Mevlyde Mezinë Saraçi: Po, në vitin '99, po. Se unë kom vazhdu aktivitetin, domethonë deri kur kanë fillu sulmet e NATO-s. Tri ditë para sulmeve të NATO-s jemi largu nga zyrat, se morëm informatë në Prishtinë prej Fehmi Aganit që, “Sulmet janë në prag, po lidhjet fizike mos i shkëputni”. Ne u largum nga objekti, por mbanim lidhjet fizike. Po masnej u vështirësun rrethanat. Rruga ime ka qenë e banuar me shumë serbë e malazezë, kriminelë që janë edhe sot të përndjekur me lista po nuk janë dënuar, as nuk janë gjykuar. Ata kanë bërë shumë krime dhe ata kanë ardhë për të më likfidu me datën 27 mars 1999, në orën 21:15 minuta. Por, fati jonë atë natë që ne kemi ikë nga oborri fqinjëve kemi depërtu edhe masnej kanë vazhdu krajetat tjera. Kur jemi shpërnda shtatë anëtarë në katër pjesë, kur nuk e kom ditë ku i kom fëmijëve, kur kom mbetë në rrugë se janë friku prej meje shumë familje, dhe me të drejtë se duhet me matë çdo veprim me kohën.

Është lehtë sot t'i akuzoj, por me kohën. Sepse, kudo ka pasë gra e fëmi, burrat gjithmonë janë mshefë, se n'fillim i ndjekshin burrat. Mirëpo, mu më ndjekshin si veprimtare. Dhe kur kom mbetë në rrugë, unë jom dëshmitare e krismave, sulmeve të 2 prillit kur janë vra familja Vejsa edhe shumë familje tjera. Në lagjen te stacioni i autobusave, unë kom qenë në qiellin e hapur bashkë me bashkëshorin tem Agimin edhe me 30 djem e burra të lagjes, s'kemi pasë kah të shkojmë. Fati ka dashtë që të shpëtojmë, sepse edhe në fatkeqësi kishte fat. Shumë herë e kom kërkua vdekjen kur mbeta rrugëve dhe i thoja burrit, "Më lejo të shkoj në shkallë të shtëpisë. Nuk do të futem brenda, le të vijnë le të më gjejnë, le të më likfidojnë bile le të shpëton lagja". Sepse gjithë lagja ka qenë e përndjekur disa ditë me radhë duke më kërkua mua.

Po fati ka deshtë që nuk m'kanë gjetë edhe fatkeqësia e madhe që në lagjen tonë mbi 85 të vrarë janë edhe ata me datën 1, 2 edhe 16 prill. Janë njerëz që i kom njoftë, që kom bashkëpunu, janë fëmi që janë moshatar të fmise të mi. Janë krime që nuk harrohen, janë gjenocid dhe asnjë njeri nuk është dënuar, edhe pse të gjithë familjarët kanë dëshmu me emra për kriminelët. E tani aktiviteti im ka vazhdu në forma të ndryshme, por në liri. Çdo rrugë ka qenë ma e lehtë, por unë jam munduar gjithë kohën t'ju dalë borxh njerëzve të vrarë. Jam munduar duke iu bërë përkujtime çdo vit me 1, 2 prill edhe 16. Kom organizu përkujtime të jashtëzakonshme me mijëra veta, kemi bërë homazhe çdo vjet.

Por, sivjet kom arritë ta bëj ni projekt realitet, ta boj librin për krimet e luftës 1999, domethonë, 1, 2 prill '99, si monografi kushtuar martirëve, dëshmorëve të bashkësisë të parë lokale aty ku jetoj, ku i kom përjetu ato tmerre. Edhe gjithë librin e kam punuar vet në bashkëpunim me familjarë edhe e kom mbledhë penzionin gjatë ni viti dhe e kom botu me mjete të mia, ua kam bërë dhuratë familjeve me 2 prill. Me 2 prill e kom bërë promovimin në Gjakovë në Pallatin e Kulturës "Arsim Vokshi", në prani të familjarëve. Ka qenë promovim krejt ndryshe, jo promovim i im si shkrimtare, por promovimi i vlerave të lirisë, promovimi i martirëve, të dëshmorëve dhe për familjen ka qenë dhurata ma e madhe që kom mujtë me ua bo deri tani.

Jom shumë krenare që kom mbrri me bo, ka qenë shumë vështirë me i mbledhë mjetet, sepse unë gëzoj ni penzion si të gjithë tjetër, kontributdhënëse dhe nuk kom të ardhura tjera. Por, dëshira ime ka qenë që për ata që janë të pavdekshëm dhe unë jom e vdekshme, e kom obligim të bëjë diçka dhe e bëra. Mandej, aktiviteti vazhdon. Nuk du t'i akuzoj individë të ndryshëm për padrejtësi, por padrejtësitë e mia kanë vazhdu edhe mbas luftës prej njerëzve me interesa të ngushta. Ka mungu edhe përkrahja e Lidhjes Demokratike, jo vetëm për mu, por për krejt gratë që kanë dhanë shumë kontribut me dekada. Deri më vdekjen e Ibrahim Rugovës, presidentit historik, kemi pasë përkrahje edhe oferta edhe respekt edhe punë. Pas vdekjes së presidentit Doktor Ibrahim Rugova, Lidhja Demokratike disi e murrë të mrapshtën me interesa të ngushta, mungoi edhe përkrahja e grave ndaj grave, u zëvendësunë gratë me gra si numra. Por, mua nuk ma penguan aktivitetin, sepse unë kom punu në baza vullnetare edhe pse 13 vite kom mbetë e pa punë si profesoreshë e gjuhës dhe letërsisë.

Pastaj kom vazhdu studimet master në menaxhimin e emergjencave ndërkombëtare për të parë se a kam ditur t'i menaxhoj emergjencat në rrafshin kombëtar në një kohë lufte, dhe kom arritur ta bëjë edhe një punim shkencor. Kam bërë shumë seminare, por tema e diplomës është një punim shkencor i pranuar, është fushë e veçantë, marrëdhëniet ndërkombëtare edhe emergjencat ndërkombëtare për të cilat nuk kom mundur të bëjë një botim, sigurisht në marrëveshje me Kolegjin Biznesi që është edhe pronar i përbashkët me mua i materialit tim, sepse si student e kemi obligim t'ua japim edhe të drejtën, domethonë kolegjit si institucion.

Kisha pasë dëshirë edhe atë ta botoj. Shkruaj, botoj, marrë pjesë në aktivitete humanitare, vizitoj familjarë, u rri karshi me ato mundësi të mia. Jom aktive në pjesë të ndryshme të aktiviteteve, në promovime, në organizime. Kom punu ni vit si kryetare e shoqatës Qendra Kombëtare e Shkrimtarëve "Gjakova", në grumbullimin e dëshmive për krime lufte, të cilat i kemi deponuar bashkë me koleget e tjera në Prokurorinë Speciale për Krime Lufte. Kemi bashkëpunu edhe me policinë. Vazhdoj të punoj gjithçka në dobi të kombit pa kompenzim, sepse për mu është kompenzim liria e Kosovës. Familja ime edhe është bagazhi im moral, intelektual edhe atdhetar ndaj kombit, ndaj atdheut edhe ndaj gjithë njerëzve të mirë.

Anita Susuri: Zonja Mevlyde, nëse keni edhe diçka me shtu që keni harru, nëse mendoni që duhet me u cekë mundëni me thanë.

Mevlyde Mezini Saraçi: Unë mendoj se kom shumë momente të rëndësishme në jetë që është shumë vështirë për ni takim apo bisedë. Por dua të them që jom shumë mirënjohëse për juve edhe organizatën e juj që po boni shpalosjen e aktiviteteve tona historike, sepse sigurisht që jo vetëm unë, por na jemi si njerëz të vdekshëm, dhe historia jonë, domethonë aktiviteti edhe kontributi individual vdes bashkë me njeriun se ato mbesin të thëna apo të pashkruar. Përveç formës që unë dua ta plasoj përmes shkrimeve të mia poetike, në roman, në libra monografik, për mua është ni moment shumë i rëndësishëm, jom shumë mirënjohëse, shumë falënderuese që ni gjeneratë e re ka kaq shumë interesim edhe po bon ni punë të dokumentuar për Kosovën. Kjo është baza e historisë së Kosovës të cilën ju e plasoni edhe te gjeneratat e sotshme, po edhe të ardhshme dhe e ngritni vetëdijen e popullit tonë se gjërat e shkruara dhe të regjistruara mbesin historike dhe janë bazament i fortë për të vazhduar më tutje. Faleminderit shumë.

Anita Susuri: Faleminderit shumë.